



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË
INFORMACIONIT NË AUTORITETIN SHTETËROR TË
INFORMACIONIT GJEOHAPËSINOR**

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

**“MBI AUDITIMIN E SISTEMEVE TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT NË
AUTORITETIN SHTETËROR TË INFORMACIONIT GJEOHAPËSINOR”**

Tiranë, më 14.07.2021

PËRMBAJTJA

Nr.	EMËRTIMI	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3-5
1	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	3
2	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	3-5
3	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	5
II.	HYRJA	6-9
1	Objektivat dhe qëllimi	6
2	Qëllimi i auditimit	6
3	Identifikimi i çështjeve	6-7
4	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar	7
5	Përgjegjësitë e audituesve	7-8
6	Kriteret e vlerësimit	8
7	Standardet e auditimit	8
8	Metoda e auditimit	9
9	Dokumentimi i auditimit	9
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	11-49
1	Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	11
2	Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	12-49
	2.1 Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK	12-20
a	Strategjia, procedurat dhe rregulloret në TIK	12-18
b	Burimet njerëzore në TIK	18-20
	2.2 Auditimi i zhvillimit dhe blerjes në teknologjinë e informacionit	21-27
a	Zhvillimi i procedurave në lidhje me TIK dhe marrëveshjet në nivel shërbimi	21-27
	2.3 Siguria e Informacionit	28-29
a	Mekanizmat, identifikimi dhe adresimi i risqeve në TIK	28-29
	2.4 Auditimi i sistemeve	30-49
a	Auditimi mbi kontrollet e aplikacioneve dhe të dhënat Input/Output	30-49
IV	GJETJET DHE REKOMANDIMET	50-56
V	ANEKSE	57-64

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) mbështetur në nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, datë 27.11.2014, zhvilloi auditimin teknologjisë së informacionit në ASIG, nga data 19.01.2021 deri më datë 15.04.2021.

Grupi i auditimit pas mbledhjes së informacionit gjatë fazës studimore nëpërmjet intervistave dhe pyetësorëve përcaktoi zonat më me risk.

Kërkesat për informacion sipas fushave përkatëse u hartuan në përputhje me Manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit, ndërsa me Manualin Aktiv të auditimit IT u analizuan dhe vlerësuan elementët më të rëndësishëm të matricave.

I.1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Projekti i auditimit, për auditimin e Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit, në Autoritetin Shtetëror të Informacionit Gjeohapësinor, është pjesë e Planit Vjetor 2021 të auditimit të KLSH-së, miratuar nga Kryetari i KLSH. Projektimi i këtij auditimi, është bërë bazuar në një analizë risku, si gjatë hartimit të planit vjetor, po ashtu edhe gjatë hartimit të Programit të Projektit të Auditimit, ku KLSH, ka vlerësuar si të rëndësishëm auditimin e sistemeve të teknologjisë që ASIG disponon, për të garantuar disponibilitet dhe integritet të të dhënave. Siguria e Informacionit është bërë gjithnjë e më shumë e rëndësishme për institucionet, kjo si pasojë e rritjes së kompleksitetit të kontrollit të aksesit dhe ruajtjes së konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë së të dhënave nga marrëdhëniet e rrjeteve publike me ato private dhe nga bashkë përdorimi i burimeve të informacionit. Siguria e Informacionit mund të përcaktohet si mundësia e një sistemi për të mbrojtur informacionin dhe burimet e sistemeve në përputhje me termat e konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë. Sistemet e informacionit janë bashkime komplekse të teknologjisë, proceseve dhe njerëzve që funksionojnë së bashku për të rregulluar përpunimin, ruajtjen, dhe transferimin e informacionit për të mbështetur misionin e institucionit dhe funksionet e tij. Lidhur nga sa më sipër, çdo institucion shtetëror që ofron shërbime ndaj qytetarëve e ka si detyrim ndërtimin e programit të sigurisë së informacionit me elementët kyç të cilët janë: “Mjedisi i sigurisë së informacionit, Vlerësimi i riskut, Politikat e sigurisë, Organizimi i sigurisë së TIK, Menaxhimi i komunikimeve dhe operacioneve, Menaxhimi i aseteve, Siguria e burimeve njerëzore, Siguria fizike dhe mjedisore, Kontrolli i aksesit, Menaxhimi i incidenteve të sigurisë së TIK, Menaxhimi i vazhdueshmërisë së biznesit, Përputhshmëria”.

I.2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Gjetje nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca me raportin përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
1.	Nga auditimi mbi biznes planin strategjik të pesëvjeçarit 2015-2020, rezultoi se nuk janë kryer përditësime të ndryshimeve përgjatë kësaj periudhe bazuar në pikën 5,ku citohet se “Minimalisht është e domosdoshme që Plan i Menaxhimit të rishikohet çdo vit nga ASIG për ndryshime të	Faqe 14-15	e lartë	Strukturat drejtuese të ASIG të marrin masat, për rishikimin dhe përditësimin periodik të politikave në strategjinë për vitet

	<p><i>mundshme që i përshtaten realitetit dhe zbatueshmërisë së BPS-së</i>”.</p> <p>Gjithashtu, për vitin 2020 nuk është dokumentuar arritja e objektivave të institucionit bazuar në pikën 3.1.3, ku citohet se <i>“Rishikimi i Planit Strategjik për të shqyrtuar jo vetëm feedback i cili mund të influençojë planifikimin e ardhshëm dhe vendimmarrjen, por gjithashtu shërben edhe si bazë për matjen e performancës”</i>;</p>			2020-2030 mbi “Qeverisjen e Sektorit të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri”.
2.	<p>Nga auditimi mbi të dhënat e publikuara në Gjeoportalin kombëtar rezulton se, mungojnë të dhënat gjeohapësinore dhe metadatat, për temat dhe autoritetin përgjegjës në tabelën më poshtë:</p> <p>Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB); Instituti i Shëndetit Publik (ISHP); Ministria e Industrisë dhe Energjetikës (MIE); Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM); Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN); Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR); Agjencia e Zhvillimit të Territorit (AZHT); Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM); Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile; Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit; Shërbimin Hidrografik Shqiptar (Komanda e Forcave Detare); Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM);</p>	faqe 39-40	e lartë	ASIG në bashkëpunim me autoritet përgjegjëse për temat e mësipërme që zotërojnë informacione gjeohapësinore, e që ende nuk janë publikuar në Gjeoportalin, të iniciojnë procesin e publikimit të informacionit, pra metadatën përkatëse, si një e drejtë e informimit, për të dhënat të cilat jo vetëm që janë parashikuar në aktet ligjore por nuk do të kenë së shpejti ndonjë sistemi informatik.
3.	<p>Nga auditimi u konstatua se Gjeoportali Kombëtar është pa mirëmbajtje prej datës 22.11.2018, veprim në kundërshtim me VKM nr.710, datë 21.8.2013 “Për Krijimin dhe Funksionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të</p>	faqe 24-25	e lartë	1.AKSHI të marrë masa për mirëmbajtjen dhe administrimin nga ana teknike të Gjeoportalit Kombëtarë. 2.AKSHI të identifikojë dhe

	Shërbimit” dhe udhëzimin i Ministrisë së Inovacioni dhe Administratës Publike nr.1159, datë 17.3.2014 “Për hartimin e marrëveshjes së nivelit të shërbimit”.			dokumentoje të gjithë elementët e mirëmbajtjes dhe cilësisë së shërbimeve, të cilat i ofrohen ASIG-ut.
4.	<p>Nga auditimi mbi të dhënat e popullimit të metadatës nga ASIG, u konstatuan disa problematika të cilat tregojnë për parregullsi në plotësimin e një informacioni kaq të rëndësishëm siç është metadata e informacionit gjeohapësinor për faktin se aty gjendet shpjegimi mbi çdo të dhënë informative gjeohapësinore të publikuar të vendit, por njëkohësisht si e dhënë parësore e sistemit të Gjeoportali që është dhe baza e ndërtimit të GIS Kombëtar.</p> <p>Në mënyrë të njëpasnjëshme janë renditur çështjet e konstatuara që kërkojnë marrjen e masave nga ana e subjektit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Plotësimi mbi të dhënë <i>“Kontaktoni për burimin”</i> është plotësuar në disa variante: Krijuesi, Autori apo Pronari; Në rastet kur është plotësuar <i>“Krijuesi”</i>, nuk është plotësuar institucioni që e administron apo posedon këtë të dhënë të krijuar nga dikush tjetër. - Në një rast, por nuk përjashtohet mundësia të ketë dhe raste të tjera u konstatua se <i>“Kontaktoni për burimin”</i> është vendosur ASIG në vend të INSTAT; - Konformiteti me standardet nuk shënohet tek <i>“Përputhshmëria”</i> pika 7 sipas tabelës 1 në VKM nr.1077, datë 23.12.2015, por shënohet tek <i>“Abstrakti i burimit”</i>; - <i>“Përputhshmëria”</i> pika 7 sipas tabelës 1 në VKM nr.1077, datë 23.12.2015, nuk është përfshirë tek informacioni i shkurtuar, në mënyrë që të publikojë në mënyrë të dukshme për çdo përdorues se sa konform standardit është kjo e dhënë; 	faqe 46-49	e lartë	<p>1.ASIG të marrë masa të menjëhershme për sistemimin dhe rregullimin e informacionit gjeohapësinor në të gjitha rastet që janë konstatuar gabime në plotësimin e tyre si numrat e kontaktit apo kontakti i saktë mbi burimin.</p> <p>2.ASIG të marrë në konsideratë rregullimin dhe sistemimin e informacionit gjeohapësinor në lidhje me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përkthimin e fushave në gjuhën shqip për ato që rezultojnë vetëm në anglisht; - Dhënien e informacionit nëse shtresa e aksesuar mund të downloadohet; - Riorganizimin nga ana vizuale dhe informative të Informacionit të kufizuar që paraqitet për çdo shtresë; - Plotësimin në <i>“Kushtet e aksesimit dhe përdorimit”</i>;

<ul style="list-style-type: none"> - “Kushtet e aksesimit dhe përdorimit” pika 8.1 në tabelën 1, nuk është e paraqitur në metadatë; - “Përputhshmëria” pika 7 në tabelën 1 është emërtuar në metadatë si “Kualitet” dhe popullohet me një të dhënë standarde që është standardi i INSPIRE; - Nuk jepet informacion nëse shtresa e aksesuar ka mundësi për download; - Në disa raste nuk është shënuar telefoni i kontaktit; - Gjuha e përdorur në metadatë është herë në Shqip e herë në Anglisht dhe jo e përkthyer në mënyrë të përshtatshme; <p>Nga ana vizuale “Informacioni” nuk tregon dukshëm dhe në mënyrë të zgjedhur informacion për lexuesin, si institucioni nga e cila kjo e dhënë buron, konformiteti etj. Në rastet e institucioneve që nuk kanë përditësuar informacionin gjeohapësinor, Informacioni të dalë aktiv kur sapo përdoruesi të zgjedhë shtresën, duke i dhënë mundësinë përdoruesit të lexojë së pari metadatën për këtë shtresë e më pas të mund të navigojë.</p>		<ul style="list-style-type: none"> - Plotësimin e të dhënës së përputhshmërisë dhe përfshirjen e saj në informacionin paraprak të çdo shtrese që i paraqitet përdoruesit në vendin e duhur. - “Kontakttoni me burimin” të plotësohet me institucionin nga i cili ASIG i ka marrë të dhënat që po publikohen, ndërsa informacioni mbi gjenerimin historik të të dhënave të jetë informacion i dhënë nëpërmjet abstraktit për atë kohë sa është e pamundur nëpërmjet kësaj forme të kemi të renditur të gjitha burimet.
---	--	---

I.3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit

Grupi i auditimit mbështetur në Standardet ndërkombëtare të Auditimit përkatësisht në ISSAI 100, ISSAI 5300, ISSAI 5310 si dhe nenet 3 dhe 14, të ligjit nr. 154 "Për Organizimin dhe Funksonimin e KLSH", datë 27.11.2014, konstaton se, ASIG me gjithë arritjet në ngritjen e Gjeoportalit Kombëtar, nuk ka mundur të përfshijë në një të vetëm, të gjitha sistemet e informacionit gjeografik ndërtuar për tema të veçanta, që do të thotë se ende nuk disponojmë një sistem të qendëruar “GIS Kombëtar”. Gjeoportali është vetëm një hallkë e GIS Kombëtar, nëpërmjet të cilit sigurohet publikimi i të dhënave gjeohapësinore, në opinionin e grupit të auditimit, mungesa e bashkëpunimit nga ana e institucioneve të përcaktuara në ligjin nr.72/2012, datë 20.7.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe mungesa e bashkëpunimit me AKSHI-n kanë ndikuar në mos arritjen e objektivave institucional të ASIG.

II. HYRJE

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH*”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 47/2 prot, datë 11.02.2021, miratuar nga Kryetari i KLSH, me afat auditimi 19.01.2021 deri në 15.04.2021, në subjektin e auditimit Autoriteti Shtetëror i Informacionit Gjeohapësinor në vijimësi “ASIG”, ku periodha e audituar ishte 01.01.2019 deri në 31.12.2020, u krye auditimi me objekt “Auditimin e Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit”, nga audituesit:

1. EC, *përgjegjëse grupi*;
2. MH, *anëtar*;
3. AK, *anëtare*;
4. MP, *anëtare*;

II.1. Objekti i auditimit

Objekti i auditimit IT është përcaktimi nëse institucioni arrin objektivat e tij duke përdorur burimet IT në mënyrë efektive dhe në përputhje me: kërkesat ligjore/rregullative, integritetin, si dhe disponueshmërinë e sistemeve të informacionit dhe të dhënave që gjenden në të.

II.2. Qëllimi i auditimit

Qëllimi i auditimit IT është vlerësimi nëse se ekzistojnë kontrollet dhe mekanizmat e duhur me qëllim krijimin, mirëmbajtjen, zhvillimin e burimeve IT dhe funksioneve për të cilat këto burime shërbejnë.

II.3. Identifikimi i çështjeve

Grupi i auditimit pas marrjes së informacionit nga subjekti dhe përpunimit të tij vlerësoi me risk drejtimit e auditimit si më poshtë:

1. Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK

- a. *Strategjia, procedurat dhe rregulloret në TIK*
- b. *Burimet njerëzore në TIK*

Elementet kryesorë që do të auditohen janë: Strategjia, procedurat dhe rregulloret e hartuara për teknologjinë e informacionit, burimet njerëzore të jashtëm¹ apo të brendshëm të angazhuar për mbarëvajtjen e IT, përshkrimet e punës si dhe kualifikimet e kërkuara apo të fituara për ushtrimin e detyrave funksionale.

2. Auditimi i zhvillimit dhe blerjes në teknologjinë e informacionit

- c. *Zhvillimi i procedurave në lidhje me TIK dhe marrëveshjet në nivel shërbimi*

Nga kontrolli në regjistrin e procedurave të prokurimit realizuar në vitin 2019 – 2020 rezulton se janë zhvilluar gjithsej 5 procedura që lidhen me shërbime në teknologjinë e informacionit. Tre nga procedurat janë Blerje me vlerë të vogël me fond limit 740,000 lekë pa TVSh dhe fond realizimi 569,000 lekë pa TVSh.

3. Siguria e Informacionit

- a. *Mekanizmat, identifikimi dhe adresimi i risqeve në TIK*

Auditimi drejt këtij moduli do të ketë në fokus vetëm mekanizmat, identifikimin dhe vlerësimin e risqeve që lidhen me teknologjinë e informacionit në institucionin në auditim.

4. Auditimi i sistemeve

- a. *Auditimi mbi kontrollet e aplikacioneve dhe të dhënat Input/Output*

¹ Outsource

Verifikim i kontrolleve të aplikacionit për të dhënat Input/Output ka si qëllim të vlerësojë kontrollet e implementuara në aplikacion si dhe hyrjen me saktësi të të dhënave dhe raportimin e tyre në funksion të objektivave të institucionit.

II.4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese:

ASIG ka këto përgjegjësi të cilat janë bazuar në nenin 7, të ligjit nr. 72/2012, datë 20.7.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, sipas te cilit:

- a) zbaton politikën kombëtare për infrastrukturën kombëtare të informacionit gjeohapësinor;
- b) është përgjegjës për projektimin, ndërtimin, mirëmbajtjen dhe përditësimin e Kornizës Referuese Gjeodezike;
- c) merr vendime për mbledhjen, përpunimin dhe përditësimin e informacionit gjeohapësinor nga autoritetet publike, sipas temave përkatëse;
- ç) përcakton standardet shtetërore dhe rregullat uniforme për krijimin e GIS-it, për secilën temë, dhe për krijimin e GIS-it Kombëtar, në përputhje me standardet evropiane përkatëse dhe harton rregullat që lidhen me krijimin, përditësimin, shkëmbimin, aksesin dhe përdorimin e informacionit gjeohapësinor dhe shërbimeve që lidhen me të;
- d) siguron ndërveprueshmërinë e grupeve dhe shërbimeve të informacionit gjeohapësinor, si dhe harton rregulla të hollësishme për realizimin e ndërveprueshmërisë;
- dh) administron informacionin gjeohapësinor të mbledhur, të përpunuar dhe të përditësuar nga autoritetet publike, sipas temave përkatëse;
- e) siguron bashkërendimin e punës gjatë aktiviteteve dhe marrjes së nismave që lidhen me informacionin gjeohapësinor në sektorin publik dhe privat;
- ë) krijon dhe administron Gjeoportalin Kombëtar dhe garanton aksesin e publikut dhe subjekteve të interesuara, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;
- f) mbikëqyr zbatimin e kuadrit rregullator të vendosur nga ky ligj, aktet nënligjore të dala në zbatim të këtij ligji dhe, në përputhje me politikat e zhvillimit të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave, u paraqet autoriteteve përkatëse propozime për ndërhyrje legjislative që lidhen me to;
- g) kujdeset për edukimin dhe rritjen e kapaciteteve të aktorëve të përfshirë në proceset që lidhen me infrastrukturën kombëtare të informacionit gjeohapësinor, si dhe për përhapjen e informacionit që lidhet me të te grupet e interesit dhe te publiku;
- gj) përfaqëson shtetin në organizatat evropiane dhe ndërkombëtare, anëtarësimi në të cilat i shërben funksionimit dhe modernizimit të infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor;
- h) përfaqëson shtetin, për çdo çështje tjetër që lidhet me infrastrukturën e informacionit gjeohapësinor.

II.5. Përgjegjësitë e audituesve:

Kontrolli i Lartë i Shtetit, auditoi ASIG, për periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2019 deri në 31.12.2020, duke i kushtuar vëmendje çështjeve që lidhen me strategjinë, burimet njerëzore dhe ato të teknologjisë që i shërbejnë të dhënave të publikuara në Gjeoportalin Kombëtar të informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë.

Nga Grupi i auditimit, me përgjegjësi të plotë, janë analizuar të gjitha çështjet që përmban Programi i Auditimit nr. 47/2 prot, datë 11.02.2021, miratuar nga Kryetari i KLSH. Në realizimin e këtij Projekt Auditimi, grupi i auditimit është mbështetur në bazën ligjore mbi të cilën funksionon KLSH, standardet e auditimit si dhe në legjislacionin e fushës në të cilën operon ASIG. Gjithashtu, gjatë veprimtarisë audituese, është siguruar një evidencë e përshtatshme auditimi, në të cilën jemi mbështetur për nxjerrjen e konkluzioneve dhe dhënien e rekomandimeve.

II.6. Kriteret e vlerësimit:

Kriteret e vlerësimit janë bazuar në ligjet, rregulloret në fuqi, standardet ndërkombëtare COBIT dhe ISSAI 5300 për auditimin e Teknologjisë së Informacionit si dhe Manualin e Teknologjisë së Informacionit. Opinioni i auditimit mbështetet në praktikat më të mira, Standardet Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Auditimit. Në këtë raport krahas gjetjeve që janë konstatuar, grupi i auditimit ka rekomanduar disa masa organizative, për përmirësimin e situatës.

Aktet ligjore dhe rregullative mbi të cilat është mbështetur vlerësimi janë si më poshtë:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (nenet 162-165 si dhe nenet 78,83);
- Ligji nr. 154/2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji nr. 72/2012 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar “Për Prokurimet Publike”
- Ligji nr. 10325, datë 23.09.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”;
- VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”
- Vendim nr. 673, Datë 22.11.2017 për “riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar;
- VKM nr. 147, datë 20.2.2013, Për Miratimin e Rregullores "Për Organizimin dhe Funksonimin e ASIG - AKSHI”;
- VKM nr. 669, datë 7.8.2013, "Për Miratimin e Rregullave për Përcaktimin, Krijimin dhe Realizimin e Kornizës Referuese Gjeodezike Shqiptare (KRGJSH), si Metadatë", i ndryshuar me VKM nr. 322, datë 27.04.2016 dhe VKM-në nr. 359 datë 29.05.2019;
- VKM nr. 1077, datë 23.12.2015, Për miratimin e rregullores “Për Krijimin, Ruajtjen dhe Përditësimin e Metadatave, Strukturën e Katalogimit dhe Afatet e Krijimit të Matadatave Specifike për çdo Temë”;
- VKM nr.942, datë 19.11.2015, Për miratimin e rregullores "Për Planifikimin dhe Realizimin e Fotografimit Ajror të Territorit të Republikës së Shqipërisë”;
- VKM nr. 399, datë 19.06.2019, “Rregullat për Shkëmbimin e Grupeve dhe të Shërbimeve të të Dhënave Gjeohapësinore mes Autoriteteve Publike”;
- VKM nr. 451, datë 3.7.2019, "Për Rregullat Uniforme të Infrastrukturës së Informacionit Gjeohapësinor”;
- VKM nr. 402, datë 20.05.2020, Për miratimin e dokumentit të politikave “Për Qeverisjen e Sektorit të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri, 2020-2030”;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t;
- Udhëzues dhe Manuale të Auditimit të Teknologjisë së Informacionit si: ISSAI 5300, Manuali Aktiv i Auditimit TI si dhe Standardet e COBIT; etj.

II.7. Standardet e auditimit:

Auditimi është kryer, në përputhje me Kodin Etik, Standardet dhe teknikat e auditimit, duke përfshirë intervista, testim, analiza të të dhënave të cilat u gjykuan se ishin të nevojshme, për të dhënë një vlerësim sa më objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë, duke u fokusuar veçanërisht në standardet e fushës së auditimit të TIK, si: COBIT 4.1, Manuali i Auditimit IT, ISSAI 5310 si dhe standardet ndërkombëtare të teknologjisë së informacionit.

II.8. Metodatat e auditimit:

Metodat mbi auditimin e sistemeve të Teknologjisë së Informacionit që grupi i auditimit ka ndjekur në ASIG, janë si më poshtë:

- Intervista zhvilluar në subjekt me personat përgjegjës;
- Verifikime të sistemit si përdorues;
- Shqyrtimi i dokumentacionit rregullator të institucionit;
- Analizimi i të dhënave të eksportuara nga sistemi;

II.9. Dokumentimi i auditimit:

Dokumentimi i auditimit është bazuar në Rregulloren e procedurave të auditimit të KLSH si dhe në manualin aktiv të auditimit të Teknologjisë së Informacionit në të cilin janë përfshirë:

- Planifikimi, qëllimi dhe objektivat e auditimit;
- Programi i auditimit;
- Evidencat e grumbulluara në lidhje me të dhënat e sistemit, raporte të ndryshme me të dhëna nxjerrë nga sistemi;
- Letrat e punës mbajtur nga audituesit sipas detyrave të përcaktuara gjatë fazës së auditimit në terren;

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

III.1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

ASIG, është institucioni përgjegjës për standardizimin dhe publikimin e informacionit gjeohapësinor në vendin tonë. Nisur nga ky fakt u vlerësua me rëndësi auditimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit nga KLSH, me qëllim vlerësimin e kontroleve dhe mekanizmat që janë ndërtuar për krijimin, mirëmbajtjen, zhvillimin e burimeve IT dhe funksioneve për të cilat këto burime shërbejnë.

ASIG, e ushtron aktivitetin e tij bazuar në ligjin nr. 72/2012, datë 28.06.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”.

Misioni i ASIG: Krijimi i infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor, në Shqipëri, bazuar në standardet evropiane të Direktivës 2007/2/EC “INSPIRE” të Parlamentit dhe Këshillit Evropian.

Objektivat e ASIG:

1. Ndërtimi i Kornizës Referuese Gjeodezike Shqiptare sipas standardeve evropiane, për të mundësuar kryerjen e punimeve gjeodezike dhe hartografike të sakta, me mjete dhe metoda bashkëkohore.
2. Zhvillimi, funksionimi dhe përditësimi i GIS-it dhe Gjeoportalit Kombëtar që ofron informacion, të dhëna dhe shërbime gjeohapësinore, në përputhje të plotë me standardet e Direktivës 2007/2/EC “INSPIRE”.
3. Koordinimi dhe bashkëpunimi me autoritetet publike përgjegjëse, për mbledhjen, përpunimin dhe përditësimin e informacionit gjeohapësinor, për hartimin dhe implementimin e standardeve në fushën e gjeoinformacionit dhe krijimin e NSDI-së.

Disa nga përgjegjësitë e ASIG janë:

- a) Zbaton politikën kombëtare, për infrastrukturën kombëtare të informacionit gjeohapësinor;
- b) Merr vendime për mbledhjen, përpunimin dhe përditësimin e informacionit gjeohapësinor nga autoritetet publike;
- c) Përcakton standardet shtetërore dhe rregullat uniforme për krijimin e GIS-it, për secilën temë, dhe për krijimin e GIS-it Kombëtar, në përputhje me standardet evropiane përkatëse dhe harton rregullat që lidhen me krijimin, përditësimin, shkëmbimin, aksesin dhe përdorimin e informacionit gjeohapësinor dhe shërbimeve që lidhen me të;
- d) Siguron ndërveprueshmërinë e grupeve dhe shërbimeve të informacionit gjeohapësinor, si dhe harton rregulla të hollësishme për realizimin e ndërveprueshmërisë;
- e) ASIG ka të përcaktuara një sërë objektivash, të cilat renditen si në vijim: Ndërtimin e Kornizës Referuese Gjeodezike Shqiptare sipas standardeve evropiane për të mundësuar kryerjen e punimeve gjeodezike dhe hartografike të sakta, me mjete dhe metoda bashkëkohore.
- f) Zhvillimin, funksionimin dhe përditësimin e GIS-it dhe Gjeoportalit Kombëtar që ofron informacion, të dhëna dhe shërbime gjeohapësinore, në përputhje të plotë me standardet e Direktivës 2007/2/EC “INSPIRE”.
- g) Koordinimin dhe bashkëpunimin me autoritetet publike përgjegjëse, për mbledhjen, përpunimin dhe përditësimin e informacionit gjeohapësinor, për hartimin dhe implementimin e standardeve në fushën e gjeoinformacionit dhe krijimin e NSDI-së, etj.
- h) Gjeoportali Kombëtar i shërben drejtpërdrejt qeverisjes së hapur, që në thelb ka politikën e të dhënave të hapura për qytetarët, duke u ofruar shërbime cilësore.

III.2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit:

III.2.1. Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK

a. Strategjia, procedurat dhe rregulloret në TIK

Objektivi. Konfirmimi nëse ekziston një strategji IT, e cila përfshin plan IT dhe proceset, për zhvillimin, aprovimin, zbatimin dhe mirëmbajtjen e strategjisë, e cila është e lidhur me strategjinë dhe objektivat e institucionit. Garantimi se ekzistojnë strukturat, politikat dhe procedurat që mundësojnë institucionin të arrijë qëllimin e tij.

Në përmbushje të drejtimit të auditimit “*Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK*”, u shqyrtuan dokumentacionet e mëposhtme:

- “Biznes Plani Strategjik”, për Informacionin Shtetëror të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri 2015-2020;
- Strategjia Ndërsektoriale “Akhenda Dixhitale e Shqipërisë 2015-2020”;
- Vendimi nr. 402, datë 20.05.2020, për miratimin e dokumentit të politikave “Për Qeverisjen e Sektorit të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri, 2020-2030”;
- Raportet e auditimit të jashtëm realizuar në periudhën objekt auditimi;
- Manuale, rregullore, standarde;
- Raporte ndërkombëtare;
- Të dhënat e publikuara në faqen web <http://www.asig.gov.al/>, etj.;

ASIG e ushtron aktivitetin e tij bazuar në ligjin nr. 72/2012, datë 28.06.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”.

Strategjia dhe Planifikimi IT

Strategjia e IT përfaqëson lidhjen e përbashkët midis objektivave të Strategjisë së IT dhe atyre të strategjisë së institucionit. Objektivat e strategjisë së IT duhet të marrin parasysh nevojat e tashme dhe të ardhshme të biznesit, kapacitetin aktual të IT për të ofruar shërbime dhe kërkesat e burimeve. Strategjia duhet të marrë në konsideratë ekzistencën e infrastrukturës dhe arkitekturës së IT, investimeve, modelit të ofrimit, burimet duke përfshirë stafin, si dhe paraqitjen e strategjisë që integron këto elementë në një qasje të përbashkët, për të mbështetur objektivat e institucionit.

Si pjesë përbërëse e AKSHI-t, ASIG mbështetet në Strategjinë Ndër sektoriale “Akhenda Dixhitale e Shqipërisë 2015-2020”, gjithashtu në Strategjinë e vetë institucionit “Biznes Plani Strategjik”, për ASIG në Shqipëri 2015-2020.

Prioriteti i Strategjisë Ndër sektoriale “Akhenda Dixhitale e Shqipërisë 2015-2020” bazohet në krijimin e Infrastrukturës Kombëtare të të dhënave Gjeohapësinore. Kjo fokusohet në bashkërendimin ndërinstitucional për mbledhjen, përpunimin dhe përditësimin e të dhënave gjeohapësinore si input për NSDI; Krijimin e një rrjeti të unifikuar gjeodezik, për informacionin hartografik shqiptar duke përdorur rrjetin gjeodezik kombëtar shqiptar; Krijimi i një sistemi të integruar gjeoinformacioni në Shqipëri sipas direktivës INSPIRE dhe përdorimi nga institucionet shtetërore dhe publiku i gjerë; etj.

Ministria e Inovacionit dhe Administratës Publike në bashkëpunim me BIG (Bordi, për Informacionin Gjeohapësinor) në mbledhjen e datës 16.07.2015 kanë miratuar “Biznes Planin Strategjik për ASIG 2015-2020”.

Realizimi i “Biznes Planit Strategjik për ASIG” është financuar nga qeveria e Norvegjisë, si pjesë e iniciativës dhe projektit, për ngritjen dhe zhvillimin e Infrastrukturës Kombëtare të të

Dhënave Gjeohapësinore (NSDI) në Shqipëri dhe përmes Autoritetit Norvegjez të Hartografisë dhe Kadastrës “SK”.

Gjatë periudhës së pesëvjeçarit 2015-2020 “Biznes Plani Strategjik” për ASIG nuk është përditësuar, bazuar në pikën 5, ku citohet se “Minimalisht është e domosdoshme që Plan i Menaxhimit të rishikohet çdo vit nga ASIG për ndryshime të mundshme që i përshtaten realitetit dhe zbatueshmërisë së BPS-së”.

Në përfundim të kësaj strategjie është hartuar një dokument në të cilin janë pasqyruar arritjet e objektivave të ASIG nga viti 2015 – 2019, realizueshmëria e të cilave deri në këtë periudhë ka qenë 82%, kjo zhvilluar në kuadër të analizës dhe përgatitjes, për hartimin dhe miratimin e dokumentit të politikave “Për Qeverisjen e Sektorit të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri 2020-2030”. Për vitin 2020 nuk është dokumentuar arritja e objektivave të institucionit bazuar në pikën 3.1.3, ku citohet se “Rishikimi i Planit Strategjik për të shqyrtuar jo vetëm feedback i cili mund të influencojë planifikimin e ardhshëm dhe vendimmarrjen, por gjithashtu shërben edhe si bazë për matjen e performancës”;

Plani Strategjik duhet rishikuar për të shqyrtuar nivelin e realizimit kundrejt objektivave të dokumentuar, i cili ngre bazat për të siguruar jo vetëm feedback-un që mund të influencojë planifikimin e ardhshëm për vendimmarrje, por edhe për matjen e performancës.

Në përfundim të Strategjisë 2015 – 2020, ASIG me Vendimin Nr. 402, datë 20.05.2020 “Për miratimin e dokumentit të politikave “Për Qeverisjen e Sektorit të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri, 2020-2030” ka miratuar një Strategji e cila përmban dymbëdhjetë politika të grupuara sipas katër synimeve afatgjata përkatësisht:

1. Politikat për të garantuar pasjen e informacionit gjeohapësinor (Politikat Nr. 1, Nr. 2, Nr. 3), që lidhen me Synimin afatgjatë, I “Disponueshmëria e informacionit gjeohapësinor”;
2. Politikat, për sigurimin e përdorimit optimal të informacionit gjeohapësinor (Politikat Nr.4, Nr. 5, Nr. 6), që lidhen me Synimin afatgjatë II “Përdorimi i informacionit gjeohapësinor”;
3. Politikat për sistemin e informacionit gjeohapësinor (Politikat Nr. 7, Nr. 8, Nr. 9), që lidhen me Synimin afatgjatë III “Funksionaliteti i Sistemit të Informacionit Gjeohapësinor Shtetëror”;
4. Politikat për qeverisjen e sektorit (Politikat Nr. 10, Nr. 11, Nr. 12), që lidhen me Synimin afatgjatë IV “Mirë Administrimi i Sektorit të Informacionit Gjeohapësinor”.

Tabela nr.1.1

POLITIKAT PRIORITARE		RENDITJA (ku 1 vlerësohet si më prioritare)
Politika 4	<i>“Përgjegjësia & detyrimi për përdorimin nga institucionet publike”</i>	1
Politika 6	<i>“Promovimi & ndërgjegjësimi për përdorimin e IG nga publiku”</i>	2
Politika 2	<i>“Gjenerimi i IG të duhur”</i>	3
Politika 9	<i>“Infrastrukturë dhe teknologji funksionale dhe e rrjetëzuar”</i>	4
Politika 8	<i>“Dije Institucionale & Kapacitete Njerëzore në Sektorin e IG”</i>	5
Politika 12	<i>“Mbi zhvillimin e Sektorit të IG”</i>	6
Politika 3	<i>“Aksesimi i lirë dhe pa pagesë i IG”</i>	7
Politika 7	<i>“Organizim Institucional Funkcional”</i>	8
Politika10	<i>“Financim i qëndrueshëm i Sektorit IG”</i>	9
Politika 1	<i>“Përcaktimi i kërkesës dhe zgjidhjes së duhur për IG”</i>	10
Politika 5	<i>“Partneritet & Përfitim reciprok me sipërmarrjet private”</i>	11
Politika 11	<i>“Mirë rregullimi i të drejtave dhe detyrimeve”</i>	12

Burimi i të dhënave: ASIG

Politikat dhe rregulloret

Politikat vendosin strukturën për operacionet e përditshme në mënyrë që të arrihen qëllimet e vendosura në përmbushje të detyrave të institucionit. Politikat mbështeten nga procedurat dhe proceset, të cilët përcaktojnë sesi do të realizohet dhe kontrollohet puna.

Një ndër vendimet e miratuara, për procedurat mbi bazën e të cilës ASIG vepron është dhe Vendimi nr. 402, datë 20.05.2020, për miratimin e dokumentit të politikave “Për Qeverisjen e Sektorit të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri, 2020-2030”. Në ASIG ky dokument vepron si Plan Strategjik Afatgjatë.

Dokumenti i politikave është një dokument për sektorin e informacionit gjeohapësinor, i shoqëruar me një program masash për jetësimin e tyre.

Politikat kryesore të përfshira në këtë dokument janë:

1. Politikat mbi disponueshmërinë e Informacionit Gjeohapësinor (IG);
2. Politikat e përdorimit të Informacionit Gjeohapësinor (IG);
3. Politikat e sistemit funksional të Informacionit Gjeohapësinor (IG);
4. Drejtimet e politikave për mirë administrimin e sektorit të IG;

ASIG vepron bazuar në një sërë rregulloresh të miratuara si:

- ✓ Rregullore për sigurinë e Gjeoportalit Kombëtar të Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor;
- ✓ Rregullore për mbrojtjen e të dhënave të Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor;

- ✓ Rregullore për Administrimin e Sistemit ALBCORS;

- ✓ Rregullore për ndërtimin dhe përditësimin e Faqes Zyrtare të ASIG;

- ✓ Rregullore e Gjeoportalit Kombëtar të ASIG, rregullore e përditësuar; qëllimi i së cilës është përcaktimi i rregullave dhe procedurave që sigurojnë mbrojtjen, integritetin dhe disponueshmërinë e informacionit gjeohapësinor në Gjeoportalin Kombëtar. Në pikën 8 *Garantimi i rregullores* citohet si në vijim: “Përgjegjës për mbikëqyrjen, zhvillimin, vënien në shfrytëzim, përditësimin dhe zbatimin e kësaj rregulloreje është / janë specialistët e Sektorit të Gjeoportalit dhe Sigurisë, dhe specialistët e GIS-it Kombëtar pranë Drejtorisë GIS-it dhe të Gjeoportalit të cilët paraqesin çdo 3 muaj drejtorit të drejtorisë një raport mbi zbatimin e kësaj rregulloreje dhe çdo problematikë të hasur që ka të bëjë me sigurinë e Gjeoportalit Kombëtar”.

- ✓ Grupit të auditimit i është vendosur në dispozicion edhe Memo me nr. 281 Prot., datë 02.09.2020 në lidhje me hartimin e Rregullores mbi Infrastrukturën TIK të ASIG hostuar pranë DataCenter-it Qeveritar. Objekti i kësaj rregulloreje është funksionimi korrekt dhe garantimi i sigurisë së infrastrukturës TIK të ASIG, e cila hostohet pranë DataCenter-it Qeveritar. Kontrollat periodike për të siguruar mbarëvajtjen e funksionimit të infrastrukturës, mbrojtja nga aksesimet e paautorizuara dhe realizimi i procedurave të “back-up”-ve të sistemeve që janë ngritur në këtë infrastrukturë janë pikat kryesore që do të trajtohen. Në pikën 6 *Garantimi i rregullores* citohet si në vijim: “Përgjegjës për mbikëqyrjen, vënien në shfrytëzim, përditësimin dhe zbatimin e kësaj rregulloreje është / janë specialistët e Sektorit të Gjeoportalit Kombëtar të cilët i paraqesin çdo 3 muaj drejtorit të drejtorisë një raport mbi zbatimin e kësaj rregulloreje dhe çdo problematikë të hasur që ka të bëjë me sigurinë e Gjeoportalit Kombëtar”.

– Nga auditimi u konstatua se ASIG nuk disponon raporte periodike mbi zbatimin e këtyre rregulloreve, për të matur ecurinë e institucionit.

Në Janar 2018, Drejtori i Përgjithshëm në ASIG ka miratuar “Harta e proceseve të punës (gjurma e auditit) në ASIG” në të cilën përshkruhet procesi përkatës i punës duke u bazuar në referencën ligjore përkatëse, aktiviteti i kontrollit si dhe Funkcioni / Personi përgjegjës.

Në një nga pikat e përshkrimit të proceseve të punës të Drejtorisë së GIS-it Kombëtar dhe Gjeoportalit citohet se në procesin e publikimit të të dhënave Gjeohapësinore në Gjeoportalin Kombëtar bazuar në VKM nr. 1077, datë 23.12.2015 dhe Ligjin nr. 72/2012 Sektori i GIS-it

Kombëtar duhet të procedoj si në vijim: “Nëse të dhënat nuk plotësojnë kushtet e përcaktuara institucionit përgjegjës i kthehet përgjigje zyrtare me shënimet përkatëse, për të bërë ndryshimet e duhura. Nëse të dhënat janë të ndërtuara në bazë të standardeve krijohet shërbimi e bëhet publikimi i të dhënave në Gjeoportalin Kombëtar dhe metadatave përkatëse”.

ASIG disponon një manual përdoruesi në të cilin përveç mënyrës së përdorimit të Gjeoportalit është e përfshirë edhe mënyra e regjistrimit të përdoruesve nga faqja web e Gjeoportalit Kombëtar <https://geoportal.asig.gov.al/map/?auto=true>.

Nga auditimi u konstatua se ASIG nuk disponon asnjë udhëzues apo rregullore, për menaxhimin e përdoruesve që vetë krijohen nëpërmjet web të cilët kërkojnë të aksesojnë të dhënat e Gjeoportalit Kombëtar.

Regjistrimi i përdoruesve në gjeoportalin realizohet nëpërmjet tre mënyrave:

1. Regjistrimi i përdoruesve nga ambienti i administrimit – Në këtë rast regjistrimi i përdoruesve realizohet nga Administratori i sistemit të gjeoportalit;
2. Regjistrimi i përdoruesve nga ndërfaqja publike e regjistrimit – Në këtë rast regjistrimi bëhet nga vetë përdoruesit duke plotësuar të dhënat e nevojshme për regjistrimin në gjeoportalin sipas formularit përkatës;
3. Një mënyrë tjetër e regjistrimit që përdoruesit të përdorin shërbimet dhe funksionalitetet e Gjeoportalit Kombëtar është edhe nëpërmjet portalit të e-Albania.

Grupi i auditimit e gjykon si të rëndësishme pasjen e një rregulloreje të tillë në lidhje me informimin e saktë dhe të qartë edhe të përdoruesve duke e bërë publike këtë rregullore edhe në faqen web të ASIG.

1. Titulli i Gjetjes: Strategjia në ASIG nuk është përditësuar, në lidhje me ndryshimet që ka pësuar ndër vite.

Situata: Nga auditimi mbi biznes planin strategjik të pesëvjeçarit 2015-2020, rezultoi se nuk janë kryer përditësime të ndryshimeve përgjatë kësaj periudhe bazuar në pikën 5, ku citohet se “*Minimalisht është e domosdoshme që Plan i Menaxhimit të rishikohet çdo vit nga ASIG për ndryshime të mundshme që i përshtaten realitetit dhe zbatueshmërisë së BPS-së*”.

Gjithashtu, për vitin 2020 nuk është dokumentuar arritja e objektivave të institucionit bazuar në pikën 3.1.3, ku citohet se “*Rishikimi i Planit Strategjik për të shqyrtuar jo vetëm feedback i cili mund të influencojë planifikimin e ardhshëm dhe vendimmarrjen, por gjithashtu shërben edhe si bazë për matjen e performancës*”;

Kriteri: Pika 3.1.3 Biznes Plan i ASIG-ut, ku citohet se “*Rishikimi i Planit Strategjik për të shqyrtuar jo vetëm feedback i cili mund të influencojë planifikimin e ardhshëm dhe vendimmarrjen, por gjithashtu shërben edhe si bazë për matjen e performancës*”;

Pika 5 Plani i Menaxhimit ku citohet se “*Minimalisht është e domosdoshme që Plan i Menaxhimit të rishikohet çdo vit nga ASIG për ndryshime të mundshme që i përshtaten realitetit dhe zbatueshmërisë së BPS-së*”.

Ndikim/Efekti: Mos update-imi i Strategjisë mbart riskun e keq adresimit të burimeve të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së ASIG nga ndryshimet ndër vite.

Shkaku: Mos marrje e masave të nevojshme për rishikim periodik të Strategjisë.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Strukturat drejtuese të ASIG të marrin masat, për rishikimin dhe përditësimin periodik të politikave në strategjinë për vitet 2020-2030 mbi “Qeverisjen e Sektorit të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri”.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me nr.47/8 Prot. datë 23.06.2021, “Mbi Projekt raportin e Auditimit” nga z. L.Ç., ku janë shprehur objeksione si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: “Së pari përse i takon Objektivave dhe aktiviteteve të "Plani i menaxhimit" të Biznes Planit të ASIG 2015 2020 theksojmë se ato janë parashikuar në planet vjetore të punës të ASIG për periudhën 2015 - 2020 e për rrjedhojë nuk ka ekzistuar rreziku i keq menaxhimit të burimeve. Objektivat dhe aktivitetet e parashikuara në planet vjetore të punës përcaktohen bazuar në analizat e arritjeve dhe problematikave të hasura në zbatimin e "Plani i Menaxhimit". Dokumentacioni i planeve dhe analizave vjetore të punës i është vënë në dispozicion grupit auditues. Pra nuk mund të thuhet që nuk janë marrë masa për zbatueshmërinë e BPS-së. Nuk jemi dakord me cilësimin si e lartë e rëndësisë së ndikimit se përditësimit formal të BPS-së.

Së dyti Dokumenti i Politikave "Për Qeverisjen e Sektorit të informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri 2020-2030" i miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 402, datë 20.05.2020, nuk është dokument strategjik por dokument politikash dhe bazuar në ligjin nr. 72/2012 ASIG është autoritet përgjegjës për zbatimin e politikave. Në zbatim të këtij dokumenti ASIG do të hartojë raporte vjetore për ecurinë e zbatimit të masave, të cilat do t'ia përcjellë Këshillit të Ministrave i cili është struktura përgjegjëse për hartimin e politikave.”

Qëndrimi i grupit të auditimit: Ky observacion nuk merret në konsideratë, arsyet e paraqitura nuk e justifikojnë konstatimin e grupit të auditimit. Përse i përket analizës vjetore, kjo e fundit nuk bazohet në strategji, institucionet publike e zhvillojnë edhe në mungesë të saj.

2. Titulli i Gjetjes: ASIG nuk disponon raporte periodike mbi zbatimin e rregulloreve, për matjen e ecurisë së institucionit.

Situata: Nga auditimi u konstatua se ASIG nuk disponon raporte periodike mbi zbatimin e nenit 6 të rregullores “Gjeoportali Kombëtar”, miratuar me nr.390/7 Prot., datë 19.11.2018 dhe nenit 8 të rregullores “Mbi infrastrukturën TIK të ASIG hostuar pranë DataCenter-it Qeveritar”, miratuar me nr. 281 Prot., datë 02.09.2020, që kanë për qëllim matjen e ecurisë së institucionit.

Kriteri: Neni 6 i rregullores “Gjeoportali Kombëtar”, miratuar me nr.390/7 Prot., datë 19.11.2018 dhe neni 8 i rregullores “Mbi infrastrukturën TIK të ASIG hostuar pranë DataCenter-it Qeveritar”, miratuar me nr. 281 Prot., datë 02.09.2020.

Ndikim/Efekti: Mungesë e gjurmës së auditimit në lidhje me dokumentimin e raporteve periodike dhe mos përmbushje e detyrave të përcaktuara në rregullore.

Shkaku: Nuk janë marrë masat e nevojshme administrative.

Rëndësia: E Mesme

Rekomandimi: ASIG të marrë masa, për raportimin dhe dokumentimin e detyrimeve të përcaktuara në rregulloret e Gjeoportalit Kombëtar dhe Infrastrukturën TIK të ASIG, me qëllim zbatimin dhe sigurimin e gjurmës së auditimit mbi mbarëvajtjen dhe matjen e aktivitetit të institucionit.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me nr.47/8 Prot. datë 23.06.2021, “Mbi Projekt raportin e Auditimit” nga z. L.Ç. ku janë shprehur objeksione si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: “Për periudhën e Auditimi 2019-2020, Gjeoportali Kombëtar dhe Infrastrukturën TIK është mirëmbajtur nga Operatore Ekonomike nëpërmjet kontratës të lidhur nga AKSHI "Shpenzime për mirëmbajtjen e Gjeoportalit Kombëtar". Gjatë realizimit të kësaj kontrate janë dorëzuar raportime mujore për ecurinë dhe problematikat evidentuara në sistemin e Gjeoportalit Kombëtar. Këto raportime mbulojnë të gjitha pikat e rregullores së Gjeoportalit Kombëtar dhe janë administruar nga ana e ASIG dokumente për monitorimin e situatës si për sistemin e Gjeoportalit Kombëtar ashtu dhe të infrastrukturës TIK.

Ndërsa përsa i takon periudhës Janar 2021 deri më tani raportimet mujore për monitorimin e sistemit dhe infrastrukturës TIK realizohen nga stafi i ASIG përgjegjës për administrimin e sistemit dhe dorëzohen zyrtarisht me email pranë Drejtorit të Drejtorisë GIS-it Kombëtar dhe Gjeoportalit.

Përveç këtyre raportimeve mujore nga ana e sektorit të Gjeoportalit Kombëtar realizohet raportim javor mbi performancën dhe përdorimin e sistemit të Gjeoportali Kombëtar, i cili i dërgohet me e-mail strukturës drejtuese të ASIG.

Grupit Auditues i janë vënë në dispozicion raportet mujore dhe raportet javore të sipërcituar, për të treguar mënyrën e raportimit.

Raportimi do të vazhdojë të kryhet rregullisht nga sektorët përgjegjës në ASIG, me qëllim monitorimin e zbatimit të rregullores së Gjeoportalit Kombëtar dhe Infrastrukturën TIK të ASIG.”

Oëndrimi i grupit të auditimit: Ky observacion nuk merret në konsideratë, pasi drejtoria përkatëse në ASIG duhet të përmbush pikat e rregullores, pasi kjo rregullore është për monitorimin e mbarëvajtjes së aktivitetit të brendshëm të institucionit jo mbi aktivitetin e operatorit ekonomik në institucion dhe kjo pikë në rregullore nuk i është deleguar operatorit ekonomik për zgjidhje në mënyrë që raportet e parashikuara të mos të bëhen nga institucioni. Përsa i preket raporteve javore dhe mujore ASIG nuk i ka vënë në dispozicion grupit të auditimit këto dokumentacione, por vetëm raportin vjetor.

3. Titulli i Gjetjes: ASIG nuk disponon udhëzues, për menaxhimin e përdoruesve që vetë krijohen nëpërmjet web për aksesimin e Gjeoportalit.

Situata: Nga auditimi u konstatua se ASIG nuk disponon udhëzues apo rregullore, për menaxhimin e përdoruesve që aksesojnë shërbimet dhe funksionalitetet e Gjeoportalit Kombëtar, nëpërmjet portalit E-Albania.

Kriteri: Praktikant më të mira për përdoruesit e web-it

Ndikimi/Efekti: Mungesë informacioni për përdoruesit që aksesojnë të dhënat në distancë.

Shkaku: Mungesa e një rregulloreje të plotë për menaxhimin e përdoruesve.

Rëndësia: E Mesme

Rekomandimi: Strukturat Drejtuese në ASIG të hartojnë dhe publikojnë, për përdoruesit e web-it nga portali E-Albania një udhëzues, i cili të përmbajë informacionin e plotë mbi mënyrën e regjistrimit, format e regjistrimit, kur krijimi i përdoruesit është i nevojshëm, informimin e saktë dhe qartë mbi mënyrat e aksesimit si dhe të drejtat dhe detyrimet që ka çdo përdorues i krijuar nga ndërfaqja web.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me nr.47/8 Prot. datë 23.06.2021, “Mbi Projekt raportin e Auditimit” nga z. L.Ç. ku janë shprehur objeksione si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: “Konstatimi që nuk ekziston një manual për menaxhimin e user-ave nuk qëndron. Në link-un https://geoportal.asig.gov.al/sites/default/files/2017-08/ASIG_Geoportal-Manual_përdoruesi.pdf ndodhet "Manuali i Përdoruesit" ku në faqet 11-16 shpjegohet mënyra e regjistrimit të përdoruesve nga ndërfaqja online e Gjeoportalit. Ndërsa përsa i takon kushteve të përdorimit të sistemit të Gjeoportalit Kombëtar, ASIG ka miratuar me urdhrin nr. 131 prot, datë 28.12.2018, "Termet dhe Kushtet e Përdorimit të Gjeoportalit Kombëtar". Ky dokument mund të aksesohet online në Gjeoportalin Kombëtar nga ana e përdoruesve të sistemit.

Nëse grupi auditues propozon që këto informacione të bashkohen në një dokument të vetëm atëherë ASIG do marrë masat për hartimin e këtij udhëzuesi i cili do të shërbejë për

menaxhimin e përdoruesve të cilët regjistrohen nëpërmjet mënyrës online në Gjeoportalin Kombëtar. Udhëzuesi do të shpjegojë sipas moduleve të cituara më sipër procedurën e regjistrimit dhe të drejtat që kanë përdoruesit në sistemin e Gjeoportalit Kombëtar.”

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit nuk ndryshon qëndrim, por sqaron se gjetja i referohet përdoruesve që aksesojnë shërbimet e gjeoportalit edhe nëpërmjet portalit E-Albania.

III.2.b. Burimet njerëzore në TIK

Objektivat e auditimit: Verifikimi nëse ASIG punëson punonjës të kualifikuar dhe të trajnuar, si dhe aksesimi ndaj burimeve të përshtatshme të cilat mundësojnë arritjen e objektivave të institucionit.

Në përmbushje të drejtimit të auditimit “*Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK*”, në lidhje me pikën b. *Burimet njerëzore në TIK*, u shqyrtuan dokumentacionet e mëposhtme:

- Ligji nr. 72/2012, datë 28.06.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”;
- Urdhri nr. 121, datë 31.7.2018 për “Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Autoritetit Shtetëror dhe Informacionin Gjeohapësinor”;
- Nr. 56 prot., datë 02.02.2018, shkresa e ardhur në ASIG nga AKSHI, përkatësisht nr. 528 prot., datë 30.01.2018 “Mbi zbatimin e VKM-së Nr. 673 datë 22.11.2017 për punonjësit aktualë të NJTIK në përbërje të strukturave të institucioneve dhe organeve të administratës shtetërore”;
- Nr. 195 prot., datë 27.04.2018, VKM Nr. 208, datë 20.04.2018 “Për rishpërndarjen e numrit të punonjësve organikë në njësitë e qeverisjes qendrore, për vitin 2018”, sipas të cilit referuar pikës 15, “*numri i punonjësve të ASIG për vitin 2018 reduktohet me 3 veta*”;
- Nr. 195/3 prot., datë 16.05.2018 “Propozim për ndryshim strukture”, shoqëruar me relacionin shpjegues dhe përshkrimet e punës për pozicionet e propozuara;
- Nr. 344 prot., datë 01.08.2018, Urdhri i Kryeministrit Nr. 121, datë 31.07.2018 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor”;
- Nr. 344/2 prot., datë 10.08.2018 “Për miratimin e përshkrimeve të punës”;
- Nr. 145 Prot., datë 10.05.2016 “Për miratimin e Përshkrimeve të Punës së nëpunësve të ASIG”.

ASIG e ushtron aktivitetin e tij bazuar në ligjin nr. 72/2012, datë 28.06.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”.

ASIG është institucion publik qendror dhe marrëdhëniet e punës rregullohen sipas legjislacionit në fuqi “Për nëpunësin civil” dhe procedurat e rekrutimit zhvillohen nga Departamenti i Administratës Publike.


Punonjësit e ASIG, të cilët kryejnë detyra TI në ASIG, nuk konsiderohen punonjës TIK nga Departamenti i Administratës Publike, referuar shkresës nr. 6730/1 prot., datë 09.10.2018 “Kthim përgjigje” nga DAP, protokolluar në ASIG me nr. 385/2 prot., datë 11.10.2018.

ASIG ka në strukturën e tij të miratuar një numër total prej 46 punonjësish, bazuar në Urdhri i Kryeministrit nr. 121, datë 31.7.2018 për “Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Autoritetit Shtetëror dhe Informacionin Gjeohapësinor”.

- Aktualisht, në ASIG janë dy vende vakante, konkretisht në pozicionin e specialistit në Sektorin e Gjeoportalit Kombëtar, në Drejtorinë e GIS-it Kombëtar dhe Gjeoportalit. ASIG duhet të ndër marrë masa për ngritjen e kapaciteteve njerëzore duke bërë rekrutime me qëllim plotësimin e strukturës së institucionit.

-Përshkrimet e punës, për punonjësit e ASIG hartohen dhe miratohen referuar vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës publike dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar. Për pozicionet e Sektorit të Gjeoportalit Kombëtar përshkrimet e punës janë bazuar në shkresën nr.195/3 prot., datë 16.05.2018 “Propozim për ndryshim strukture” si dhe me shkresën nr. 344/2 prot., datë 10.08.2018 “Për miratimin e përshkrimeve të punës”, miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i ASIG.

Fig.1.1: Struktura në ASIG



Burimi i të dhënave: ASIG

- Në shkresën nr. 344/2 prot, datë 10.08.2018 “Për miratimin e përshkrimeve të punës”, në një nga detyrat funksionale të specialistit konkretisht në pikën e, thuhet se ky i fundit është “Përgjegjës për sigurinë dhe mirëfunksionimin e sistemit IT të institucionit”, për të cilën grupi i auditimit gjykon se, specialisti nuk ka kapacitete teknike për teknologjinë e informacionit në mënyrë që të garantojë kryerjen e kësaj detyre. Kjo është një detyrë e adresuar jo në përputhje me njohuritë teknike dhe profesionale që ky pozicion duhet të ketë dhe duhet ti adresohet një niveli më të lartë, siç është administratori i sistemit të ASIG.

1. Titulli i gjetjes: Mungesë të burimeve njerëzore.

Situata: Nga auditimi mbi strukturën e ASIG rezultoi se nga 3 specialistë në Sektorin e Gjeoportalit Kombëtar, në Drejtorinë e GIS-it Kombëtar që përmban struktura, një vend është vakant, çfarë vë në rrezik arritjen e objektivave të këtij sektori.

Kriteri: Urdhri i Kryeministrit nr.121, datë 31.7.2018 për “Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Autoritetit Shtetëror dhe Informacionin Gjeohapësinor”.

Ndikimi/efekti: Risk në mos përmbushje të objektivave të përcaktuara.

Shkaku: -

Rëndësia: E mesme

1.1 Rekomandimi: ASIG të ndërmarrë masa, për mirë menaxhimin e burimeve njerëzore në plotësimin e vendeve vakante të Sektorit të Gjeoportalit Kombëtar, Drejtoria e GIS-it Kombëtar.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me nr.47/8 Prot. datë 23.06.2021, “Mbi Projekt raportin e Auditimit” nga z. LÇ ku janë shprehur objeksione si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: “Nga auditimi është konstatuar se në Sektorin e Gjeoportalit Kombëtar janë dy vende vakante.

Sqarojmë se në momentin e auditimit në këtë sektor ka patur vetëm 1(një) pozicion vakant pasi nga Departamenti i Administratës Publike me shkresën nr. 681 Prot, datë 27.01.2021 (bashkëlidhur) është emëruar studenti i ekselencës në pozicionin e specialistit në këtë sektor.

Shkaku i vakancës është mospublikimi nga Departamenti i Administratës Publike i pozicionit vakant Specialist në Sektorin e Gjeoportalit Kombëtar, për vitin 2020, pasi ASIG i kishte kryer të gjitha procedurat e kërkuara nga legjislacioni në fuqi.

Pozicioni vakant (i krijuar në gusht 2020), bashkë me pozicionet e tjera vakante, nga njësia e burimeve njerëzore në ASIG është deklaruar vakant dhe është dërguar në platformën HRMIS dhe administrata.al, (raporti bashkëlidhërtë cilat administrohen nga Departamenti i Administratës Publike, i cili planifikon dhe organizon procesin e publikimit të vendeve vakante. Aktualisht pozicioni i specialistit vakant në Sektorin e Gjeoportalit Kombëtar është publikuar nga Departamenti i Administratës Publike me shpalljen nr. 3644, të cilën e gjeni në linkun <http://rekrutimi.administrata.al/shpalljet/shfag/3136>.”

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Ky observacion merret në konsideratë, dhe ndryshimet janë pasqyruar në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

2. Titulli i gjetjes: ASIG nuk ka adresuar në mënyrën e duhur detyrat funksionale në përshkrimet e punës.

Situata: Nga auditimi mbi përshkrimet e punës të specialistëve, miratuar me shkresën nr. 344/2 prot, datë 10.08.2018, rezultoi se një nga detyrat funksionale adresohet gabim tek specialisti në sektorin e Gjeoportalit Kombëtar, pika ë. Grupi i auditimit gjykon se, kjo detyrë nuk është adresuar në përputhje me njohuritë teknike dhe profesionale, që specialisti gjeodet disponon, për të ofruar sigurinë dhe mirë funksionimin e sistemeve IT, detyrë e cila i ngarkohet një pozicioni me formim në administrimin e sistemit të gjeoportalit.

Kriteri: Shkresa nr. 344/2 prot, datë 10.08.2018 “Për miratimin e përshkrimeve të punës”, miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i ASIG.

Ndikimi/efekti: Risk në mos përmbushjen e detyrave të përcaktuara.

Shkaku: Nuk janë marrë masa për adresimin e detyrave tek punonjësit me kapacitetet e duhura teknike.

Rëndësia: E lartë

2.1 Rekomandimi: ASIG të ndërmarrë masa për rishikimin e detyrave funksionale të punonjësve në drejtorinë e GIS-it Kombëtar dhe Gjeoportalit, me qëllim adresimin e tyre sa më afër me formimeve profesionale.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me nr.47/8 Prot. datë 23.06.2021, “Mbi Projekt Raportin e Auditimit” nga z. LÇ ku janë shprehur objeksione si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: “Lidhur me gjetjen tuaj për rishikimin e detyrave funksionale të punonjësve në Drejtorinë e GIS-it Kombëtar dhe Gjeoportalit, sqarojmë se ASIG është në proces të miratimit të ndryshimeve ligjore në Ligjin nr. 72/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, proces ky i cili do të vijojë me rishikimin e përshkrimeve të punës, duke adresuar edhe gjetjen tuaj.”

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Nga observacionet rezulton se ASIG e ka pranuar konstatimin e grupit të auditimit.

2.2 Auditimi i zhvillimit dhe blerjes në teknologjinë e informacionit

a. Zhvillimi i procedurave në lidhje me TIK dhe marrëveshjet në nivel shërbimi

Në zbatim të programit të auditimit me nr.47/2 dt. 11.02.2021 pika 2.a “Zhvillimi i procedurave në lidhje me TIK dhe marrëveshjet në nivel shërbimi””: u audituan procedurat e realizuara për periudhën objekt auditimi si më poshtë:

1. Procedura “Printim Broshura” me fond limit 237.000 lekë pa TVSH
2. Procedura “Blerje Tонера” me fond limit 431.776 lekë pa TVSH
3. Procedura “Riparim fotokopje” me fond limit 71.311 lekë pa TVSH

Tabela 2.1

Nr.	Objekti i Prokurimit	Tipi i kontratës (mall/punë/shërbim)	Lloji i procedurës	Fondi limit me të cilin është shpallur procedura Lekë	Data e zhvillimit të procedurës	OE Fitues	Diferenca nga Fondi Limit(pa tvsh) Lekë
1	Shërbime të printimit dhe publikimit	Shërbim	Blerje me vlerë të vogël	237.000	29.09.2020	KD	59.000
2	Materiale për funksionimin e pajisjeve të zyrës (bojë printer dhe fotokopje)	Mall	Blerje me vlerë të vogël	431,776	12.04.2019	IO	110.776
3	Shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjeve të zyrave (kompjuter, etj)	Shërbim	Blerje me vlerë të vogël	71.311	22.02.2019	BE	1.311

Burimi i të dhënave: ASIG

b. U audituan gjithashtu edhe marrëveshjet e nivel shërbimi (MNSH) të cilat ASIG i ka aktive.

1. Kontrata me nr.6639 Prot datë 22.11.2018 me Objekt Shpenzime për mirëmbajtjen e Gjeoportalit Kombëtarë lidhur nga AKSHI me Bashkim OE IS sh.p.k dhe iO sh.p.k, me afat 2 vjeçar, e protokolluar në ASIG me shkresë nr.6743 Prot., datë 26.11.2018.
2. Marrëveshje e nivelit të shërbimit nga ASIG me nr. 189/1 Prot., datë. 06.06.2019 dhe AKSHI-it me nr.2409/2 Port., datë 06.06.2019, me objekt : Ofrimi i shërbimeve nga AKSHI për ASIG me qëllim rritjen e efektivitetit, kohëzgjatjes dhe kufizimin e risqeve teknike, pra në ruajtjen e integritetit. konfidencialitetin dhe vazhdueshmërisë së punës.
3. Marrëveshje e nivelit të shërbimit nga ASIG me Nr. 212/1 Prot. datë. 29.05.2017 dhe AKSHI-it me nr.1712 Port. Datë 30.05.2017, me objekt” Hostim të portaleve dhe serverëve privat virtual (vps) të Institucioneve të Administratës Publike.
4. Marrëveshje ndërmjet ASIG dhe AKSHI për krijimin e kopje “back up” në katastrofë, me vendndodhje Data Center-in e Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë (MFE).
- 5.Marrëveshje e nivelit të shërbimit nga ASIG me nr.1151 Prot. datë. 13.04.2017 dhe AKSHI-it me nr.212/4 Port. Datë 21.08.2017, me objekt “Ofrimi hapësirave fizike në Data Center-in Qeveritar – Rack për shërbimet e ASIG”.

Hostim të portaleve dhe serverëve privat virtual (vps) të Institucioneve të Administratës Publike.

1. Procedura “*Printim Broshura*” me fond limit 237.000 lekë pa TVSH

Mbasi OE i renditur i pari F.L.E.SH.” me ofertë 88.000 lekë pa TVSh. nuk është paraqitur pranë AK, u njoftua OE i renditur i dyti DK me ofertë 138.000 Lekë pa TVSh, i cili u tërhoq nga procedura

Në datë 01.10.2020 KPVV njofton OE i renditur i treti “KD” me ofertë 178.000 lekë pa TVSh. Në datë 02.10.2020, me nr.304/4 Prot. OE “KD” paraqitet pranë AK me dokumentacionin përkatës të cilat i plotësonin specifikimet teknike.

Në datë 13.10.2020, me nr.304/5 Prot. Është mbajtur Procesverbali i pranimit të shërbimit.

Rezulton se OE e ka kryer shërbimin për 8 ditë pune dhe jo për 5 ditë pune siç është e specifikuar në Ftesën për ofertë.

KPVV (Komisioni i Prokurimeve me Vlerë të Vogël) duhet të mbaj 2.136 Lekë si penalitetet për mos dorëzim brenda afatit

$$3 \text{ Ditë} * 4/1000 * 178.000 \text{ Lekë} = 2.136 \text{ Lekë}$$

1.Titulli i Gjetjes: Komisioni i Prokurimeve me Vlerë të Vogël nuk ka mbaj penalitet mbi vonesën e dorëzimit të shërbimit.

Situata: Nga auditimi i procedurës së prokurimit “*Printim Broshura*” me fond limit 237.000 lekë pa TVSH rezultoi se, dorëzimi i shërbimit nuk është realizuar në Afatet e përcaktuara në Ftesën për ofertë dhe KPVV duhet të mbante penalitet mbi vonesën për dorëzimin e shërbimit nga OE DK

Kriteri: Dokumentet standarde Ftesa për Ofertë.

Ndikimi/Efekti: Vonesa në marrjen e shërbimit dhe vënien e tij në përdorim.

Shkaku: Vonesa në lëvrimin e shërbimit nga ana e Operatorit Ekonomik DK

Rëndësia: E lartë

1.1Rekomandime: ASIG të marrë të gjitha masat e nevojshme administrative dhe ato ligjore për arkëtimin e vlerës **2.136 Lekë** nga OE KD vlerë e cila është përlllogaritur si penalitet për mos dorëzim brenda afatit të shërbimit.

Për mos përlllogaritjen dhe mbajtjen e penaliteteve në procedurën e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi, pjesëtarët e (Komisionit të Prokurimeve me Vlerë të Vogël): AS, AA, BB.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me nr.47/8 Prot. datë 23.06.2021, “Mbi Projekt raportin e Auditimit” nga z. LÇ ku janë shprehur objeksione si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: “: Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël ka vepruar sikurse është cituar në gjetjen tuaj dhe ka kryer veprimet e mëposhtme:

Në datë 01.10.2020, OE “DK” ka njoftuar nëpërmjet telefonit dhe e-mailit se tërhiqet nga procedura e prokurimit për arsye teknike.

Në datë 01.10.2020, KPVV njofton OE i renditur i treti “KD” me ofertë 178.000 lekë pa TVSh. Gjithashtu Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël argumenton se:

1- Së pari, konstatimi juaj “Ndikimi/Efekti: Vonesa në marrjen e mallrave dhe vënia e tyre në përdorim” nuk qëndron. Rekomandimi juaj për të kaluar tek operatori tjetër nuk do kishte efekt për eliminimin e vonesës, pasi minimumi do të shtynte në kohë marrjen e broshurave edhe 5 ditë të tjera (gjithmonë nëse operatori i radhës do të realizonte këtë shërbim).

2- Së dyti, konstatimi juaj i “Rëndësisë së lartë” nuk është objektiv pasi duhet analizuar pasoja e marrjes së broshurave me 3 ditë vonesë. Parë në këtë këndvështrim, sikurse sqaruam më lart

broshurat kanë qëllim informues për të tretët përgjatë gjithë vitit dhe nuk lidhen me ndonjë afat apo ngjarje të caktuar, që mund të ndikohej.

Kalimi tek operatori tjetër do të shtonte kostot për institucionin (fondi nga ky operator tek tjetri do ishte nga 178.000 lekë pa tvsh në 204.000 lekë pa tvsh) dhe do të dëmtonte operatorin i cili kishte dorëzuar pjesërisht broshurat.

Komisioni i Blerjeve me Vlerë të Vogël pranon se duhet të dokumentojë çdo situatë të paparashikuar e cila nuk sjell pasoja apo dëm ekonomik për palët dhe siguron realizimin e objektit të prokurimit dhe mirëmenaxhimit e fondeve buxhetore.

3- Së treti, auditimi i kësaj procedure nuk është parë me objektivitet, pra nëse veprimet kanë sjellë pasoja apo dëm ekonomik për institucionin. Referuar programit tuaj të auditimit me objekt "Auditimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit" kjo procedurë nuk ka lidhje me objektin e auditimit pasi "Printimi i Broshurave" nuk ka asnjë lidhje me teknologjinë e informacionit. Broshurat janë materiale informuese mbi veprimtarinë e institucionit ASIG për periudhën 2014-2019 për palët e treta.

Për sa më lart, Komisioni i Blerjeve me Vlerë të Vogël konkludon se gjetjet për procedurën "Printim Broshura" nuk qëndrojnë dhe janë në tejkalim të objektit të auditimit nga ana juaj."

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar sqarojmë se:

-Në përgjigje të pikës 1 dhe 2, në procedurat e prokurimit duhet të zbatohen me rigorozitet të gjitha afatet e kërkuara në specifikimet teknike, të cilat ju vetë i keni përcaktuar.

Nëse nuk i zbatoni atëherë kemi të bëjmë me shkelje të kontratës.

-Në përgjigje të pikës 3, Procedurat e tenderimit janë përzgjedh në bazë të pikës 2 dhe 5 të Programin e auditimit nr.47/2 Prot. datë 11.02.2021.

Prandaj këto komente nuk merren në konsideratë.

2. Procedura "Blerje Tонера" me fond limit 431.776 lekë pa TVSH

Me Kërkesën nr.134 prot, datë 29.03.2019, është miratuar blerja e materialeve për funksionimin e pajisjeve të zyrës "Bojra për printer, fotokopje..." dhe fillimi i procedurave të prokurimit.

Me urdhër të brendshëm të Titullarit nr. 7, datë 14.01.2019 është ngritur Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël i përbërë nga specialistët :

AS, AA, RM.

Me procesverbalin nr. 134/1 prot, datë 10.04.2019 Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël ka përlllogaritur vlerën e fondit limit me metodën e testimit të tregut duke nxjerrë vlerën 431 776 lekë pa TVSH.

Në këtë procedurë kanë marrë pjesë 11 operatorë ekonomikë.

Operatori ekonomik IO është shpallur fitues i procedurës.

Titullari ka miratuar procedurën e prokurimit, me Urdhër Prokurimi nr.29, datë 11.04.2019.

Marrë në dorëzim nga Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël, Procesverbal nr. 134/10 prot, datë 24.05.2019.

Kjo procedurë ishte në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të Ligjit të Prokurimit Publik.

MNSH. Për periudhën 01 Janar 2019 – 31 Dhjetor 2020 janë 5 marrëveshjet e nivel shërbimi (MNSH) aktive.

-Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) me VKM nr.673 datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e agjencisë kombëtare të shoqërisë së informacionit”

Pika 5. AKSHI, në funksion të përmbushjes së veprimtarisë së saj, ushtron kompetencat kryesore, si më poshtë vijon:

i) Organizon, kryen prokurimet e qendëruara dhe lidh kontratat për sistemet, pajisjet software dhe hardware, mirëmbajtjen, si dhe shërbimet e internetit dhe intranetit me vlerë mbi kufirin monetar të prokurimeve me vlera të vogla, për institucionet në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, sipas listës nr. 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

j) Organizon, kryen prokurimet e përqendruara dhe lidh kontratat për pajisjet TIK, përfshirë edhe ato të klasifikuara si "sekret shtetëror", për institucionet sipas listës nr. 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) është në zbatim të VKM nr.673 datë 22.11.2017, pasi është pjesë e institucioneve, të cilat mbulohet nga veprimtaria e AKSHI.

1.Titulli i Gjetjes: Gjeoportali Kombëtar është pa mirëmbajtje prej datës 22.11.2018

Situata: Nga auditimi u konstatua se Gjeoportali Kombëtar është pa mirëmbajtje prej datës 22.11.2018, veprim në kundërshtim me VKM nr.710, datë 21.8.2013 “Për Krijimin dhe Funksionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit” dhe udhëzimin e Ministrisë së Inovacioni dhe Administratës Publike nr.1159, datë 17.3.2014 “Për hartimin e marrëveshjes së nivelit të shërbimit”.

Kriteri: VKM nr.710, datë 21.8.2013 “Për Krijimin dhe Funksionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit” (Ndryshuar me VKM nr.755, datë 26.10.2016).

Ndikimi/Efekt: Shkelje të sigurisë, humbje të dhënash mos efektivitet

Shkaku: Nuk janë marrë masat për hartimin e MNSH.

Rëndësia: E lartë

1.1.Rekomandime: AKSHI të marrë masa për mirëmbajtjen dhe administrimin nga ana teknike të Gjeoportalit Kombëtarë.

1.2.Rekomandime: AKSHI të identifikojë dhe dokumentojë të gjithë elementët e mirëmbajtjes dhe cilësisë së shërbimeve, të cilat i ofrohen ASIG-ut.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me nr.47/8 Prot. datë 23.06.2021, “Mbi Projekt raportin e Auditimit” nga z. LÇ ku janë shprehur objeksione si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: “ASIG ne zbatim te VKM-se nr.673, datë 22.11.2017, "Për Riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit", i ndryshuar, i ka dërguar AKSHI-t me shkresën nr.182/2 date 2.09.2020 specifikimet teknike për procedurën "Mirëmbajtje e Gjeoportalit Kombëtar" duke qene se ne muajin Nëntor 2020 mbaronte afati i kontratës së mirëmbajtjes. ASIG ka vene ne dispozicion buxhetin e nevojshëm për zhvillimin e mirëmbajtjes te sistemit për periudhën 2021-2023. AKSHI deri ne këtë moment nuk ka zhvilluar procedurën

e prokurimit dhe për këtë arsye mirëmbajtja e sistemit te Gjeoportalit Kombëtar është duke u kryer nga ana e stafit te ASIG. Theksojmë se e njëjta problematike është vërejtur dhe ne projektet e investimeve TIK për vitin 2020 " Shtimin e kapaciteteve te Infrastrukturës IT dhe projekti "Blerjen e pajisjeve elektronike", ku procedurat e prokurimit duhet te kryhen nga AKSHI ne zbatim te VKM-se nr.673, date 22.11.2017. Për këto 2 projekte ASIG i ka dërguar zyrtarisht AKSHI-t me shkrese nr.113/2 date 15.06.2020 dhe 114 date 15.06.2020 për miratim

dokumentet e specifikimeve teknike dhe vijimin nga ana e AKSHI-t te procedurave te mëtejshme të prokurimit.

Edhe pse janë dërguar disa shkresa nga ana jone me qellim rikujtuese për zhvillimin e procedurave, kjo gjë nuk është kryer nga AK.SHI duke çuar ne mosrealizimin e projekteve gjate vitit 2020.

Për me tepër ne Dhjetor 2020 ne zbatim te Aktit Normativ nr.34, date 16.12.2020, sipas shkresës se MFE nr.23412/52 date 24.12.2020, jemi vene ne dijeni se fondi total për projektin 2020 "Shtimin e kapaciteteve te Infrastrukturës IT" i'u pakësua ASIG-ut dhe i'u shtua AKSHI-t për projekte te tjera te tyre.

Korrespondenca shkresore e sipërpërmendur i është vene ne dispozicion grupit auditues.

Për arsyet e sipërcituara ASIG ka plotësuar te gjitha detyrimet qe i takojnë dhe për realizimin e rekomandimit te mësipërm përgjegjësia duhet t'i adresohet AKSID-t. Kjo përgjegjësi konsiston ne moszhvillimin e procedurave te prokurimit Përsa i takon mirëmbajtjes se Gjeoportalit Kombëtar për te cilin janë parashikuar fondet buxhetore te nevojshme nga ana e ASIG për periudhën 2021-2024."

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar sqarojmë se AKSHI-t do t'i dërgohet një kopje e Raportit Përfundimtar të Auditimit. Prandaj këto komente nuk merren në konsideratë.

2.Titulli i Gjetjes: ASIG nuk e mat cilësinë e shërbimeve të ofruara nga AKSHI.

Situata: Marrëveshje e nivelit të shërbimit nga ASIG me nr. 189/1 Prot. datë. 06.06.2019 dhe AKSHI-it me nr.2409/2 Port. Datë 06.06.2019, me objekt : Ofrimi i shërbimeve nga AKSHI për ASIG me qëllim rritjen e efektivitetit, kohëzgjatjes dhe kufizimin e risqeve teknike, pra në ruajtjen e integritetit, konfidencialitetit dhe vazhdueshmërisë së punës.

Nga verifikimi i kësaj procedurë rezultoi se ASIG nuk e mat cilësinë e shërbimeve të AKSHI-t në kundërshtim me pikën 8.ç të udhëzimi i Ministrisë së Inovacioni dhe Administratës Publike nr.1159, datë 17.3.2014 "Për hartimin e marrëveshjes së nivelit të shërbimit".

Kriteri: Pika 8.ç e udhëzimi i Ministrisë së Inovacioni dhe Administratës Publike nr.1159, datë 17.3.2014 "Për hartimin e marrëveshjes së nivelit të shërbimit".

ç) Matja e cilësisë së shërbimit Ky seksion duhet të përcaktojë masat e marra për të matur shërbimin, në mënyrë që të arrihet ofrimi optimal i tij. Këto matje mund të përcaktohen, si: disponueshmëri të shërbimit (sa është përqindja e disponueshmërisë së shërbimit online etj.), performancë e sistemit (shpejtësia e transmetimit të të dhënave, koha e përgjigjes etj.) dhe cilësia e shërbimit (numri i "fikjeve" të paplanifikuara, anketimi i përdoruesve etj.)

Ndikimi/Efekt: Mos monitorimi i performancës së shërbimeve të ofruara nga AKSHI

Shkaku: Mos marrja e masave për monitorimin dhe dokumentimin e shërbimeve.

Rëndësia: E lartë

2.1 Rekomandime: ASIG të marrë masa të menjëhershme për matjen dhe dokumentimin e cilësisë së shërbimeve që rrjedh si detyrim i marrëveshjes në nivel shërbimi me AKSHI-n.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme të cilat janë në kundërshtim me Pikën 8.ç e udhëzimi i Ministrisë së Inovacioni dhe Administratës Publike nr.1159, datë 17.3.2014 "Për hartimin e marrëveshjes së nivelit të shërbimit".

ç) Matja e cilësisë së shërbimit Ky seksion duhet të përcaktojë masat e marra për të matur shërbimin, në mënyrë që të arrihet ofrimi optimal i tij. Këto matje mund të përcaktohen, si: disponueshmëri të shërbimit (sa është përqindja e disponueshmërisë së shërbimit online etj.), performancë e sistemit (shpejtësia e transmetimit të të dhënave, koha e përgjigjes etj.) dhe cilësia e shërbimit (numri i "fikjeve" të paplanifikuara, anketimi i përdoruesve etj.), ngarkohen me përgjegjësi: Drejtor i Përgjithshëm.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me nr.47/8 Prot. datë 23.06.2021, “Mbi Projekt raportin e Auditimit” nga z. LÇ ku janë shprehur objeksione si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: *“Në kuadër të kësaj marrëveshje Niveli të Shërbimit SLA-AKSHI-ASIG paragrafi 4. Nivelet e Shërbimeve, pika Administrimi i Disponueshmërisë specifikohen kontrollet javore/mujore që duhet të kryhen, si edhe bazuar në kontratën "Shpenzime për Mirëmbajtjen e Gjeoportalit Kombëtar", ku AKSHI është në statusin e Autoritetit Kontraktor, në të cilën janë përfshirë dhe mirëmbajtja e pajisjeve harduerë Server & Storage të hostuar në datacenterin qeveritar, janë realizuar sipas specifikimeve të SLA-së dhe dërguar nga bashkimi operatorëve raporte periodike javore/mujore mbi gjendjen e sistemit dhe infrastrukturës së Gjeoportalit Kombëtar,*

Bazuar në kontratën e mirëmbajtjes raport mujore përmbajnë rezultat e kontrolleve, si në vijim:

<i>Muaji Janar 2019 në faqet 7-41</i>	<i>Muaji Shkurt 2019 në faqet 7-45</i>
<i>Muaji Mars 2019 në faqet 7-60</i>	<i>Muaji Prill 2019 në faqet 7-62</i>
<i>Muaji Maji 2019 në faqet 7-58</i>	<i>Muaji Qershor 2019 në faqet 7-62</i>
<i>Muaji Korrik 2019 në faqet 7-59</i>	<i>Muaji Gusht 2019 në faqet 7-58</i>
<i>Muaji Shtator 2019 në faqet 7-64</i>	<i>Muaji Tetor 2019 në faqet 7-62</i>
<i>Muaji Nëntor 2019 në faqet 7-62</i>	<i>Muaji Dhjetor 2019 në faqet 7-66</i>
<i>Muaji Janar 2020 në faqet 7-66</i>	<i>Muaji Shkurt 2020 në faqet 7-57</i>
<i>Muaji Mars 2020 në faqet 7-68</i>	<i>Muaji Prill 2020 në faqet 7-64</i>
<i>Muaji Maji 2020 në faqet 7-53</i>	<i>Muaji Qershor 2020 në faqet 7-54</i>
<i>Muaji Korrik 2020 në faqet 7-52</i>	<i>Muaji Gusht 2020 në faqet 7-51</i>
<i>Muaji Shtator 2020 në faqet 7-88</i>	<i>Muaji Tetor 2020 në faqet 7-54</i>
<i>Muaji Nëntor 2020 në faqet 7-82</i>	

Grupit Auditues i është vënë në dispozicion raportimi i një muaji, për të treguar mënyrën e raportimit.

Në zbatim të Marrëveshje e Nivelit të Shërbimit SLA, ASIG- AKSHI , nga specialistja e AKSHI-t, emëruar pranë ASIG-ut, janë kryer nëpërmjet email zyrtar raportimet periodike javore mbi bazën e cilësisë së shërbimeve që i ofrohen ASIG-ut. Për këtë raportim grupit auditues i është vënë në dispozicion një përmbledhje e raporteve.

Si përfundim sqarojmë se ASIG ka menaxhuar dhe monitoruar marrëveshjet e SLA-së, Nëse këto raporte nuk janë konform pritshmërive të grupit të auditimi lutemi të na vihet në dispozicion standardi (nëse ka të tillë) se si duhet të jetë raporti për marrëveshjen SLA. Theksojmë se AKSHI nuk ka një standard raportimi të afishuar në faqen e tyre web , mbi marrëveshjet SLA..”

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar sqarojmë se: ASIG për matjen dhe dokumentimin e cilësisë së shërbimeve që rrjedh si detyrim i marrëveshjes në nivel shërbimi me AKSHI-n, duhet të bazohet në Udhëzimin e Ministrisë së Inovacioni dhe Administratës Publike nr.1159, datë 17.3.2014 “Për hartimin e marrëveshjes së nivelit të shërbimit”.

Pika 8.ç.) Matja e cilësisë së shërbimit Ky seksion duhet të përcaktojë masat e marra për të matur shërbimin, në mënyrë që të arrihet ofrimi optimal i tij. Këto matje mund të përcaktohen, si: disponueshmëri të shërbimit (sa është përqindja e disponueshmërisë së shërbimit online etj.), performancë e sistemit (shpejtësia e transmetimit të të dhënave, koha e përgjigjes etj.) dhe cilësia e shërbimit (numri i “fikjeve” të paplanifikuara, anketimi i përdoruesve etj.)

Prandaj këto komente nuk merren në konsideratë.

3.Titulli i Gjetjes: Procedura që ndiqet nga ASIG me specialistin IT të AKSHI-t për kryerjen e “Back-Up” mujor të sistemit të Gjeoportalit Kombëtar, nuk dokumentohet dhe nuk kryhen teste periodike për vlefshmërinë e ruajtjes së të dhënave të sistemit.

Situata: Marrëveshje ndërmjet ASIG dhe AKSHI për krijimin e kopje “Back-Up” në kasafortë, me vendndodhje Data Center-in e Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë (MFE).

ASIG me shkresë nr.73 Prot. Datë 13.02.2018 i është drejtuar AKSHIT për të ngrit një grup pune për të caktuar një vend të sigurt për të vendosur një kopje “Back-Up” jashtë godinë së Inovacionit si dhe kushtet teknike të përshtatshme për ruajtjen e informacionit.

AKSHI me shkresë nr.782/3 Prot Datë 21.02.2018 cakton një specialist të sektorit DRC si përfaqësues të AKSHI-t në grupin e punës.

ASIG me shkresë nr.73/2 Prot. Datë 15.08.2018 i dërgon AKSHI-t të dhënat teknike të pajisjeve të Back-Up.

AKSHI me shkresë nr.4009/1 datë. 31.08.2018 i kthen përgjigje ASIG duke përcaktuar vendin se ku do të vendoset dhe personin e kontaktit.

Nga auditimi u konstatua se: Back-Up bëhet 1 herë në muaj. Për këtë specialisti përkatës shkon në ambientet e MFE merr hard diskun nga kasaforta në të cilën ruhen kopjet dhe mbasi vjen në ambientet e ASIG i bën update të dhënat dhe e rikthen përsëri në ambiente e MFE hard diskun me të dhënat e reja.

Kriteri: Praktikrat më të mira për kontrollin e procesit të Back-Up -it mujor.

Ndikimi/Efekti: Risk në dëmtimin e pajisjes (hard disk) gjatë procesit të transportit. Komprometim i informacionit i cili bëhet Back-Up. Humbja e të dhënave.

Shkaku: Mungesa e monitorimit të procesit të Back-Up

Rëndësia: E lartë

3.1 Rekomandime: ASIG të kryej analizimin e situatës së gjithë procesit të realizimit të Back-Up dhe të marri masa të monitorojë dhe dokumentojë të gjithë procesin duke shtuar kryerjen e testeve periodike në vijimësi të marrëveshjeve me AKSHI-n.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me nr.47/8 Prot. datë 23.06.2021, “Mbi Projekt raportin e Auditimit” nga z. LÇ ku janë shprehur objeksione si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: *“Dokumentimi për realizimin e backup është realizuar deri më tani nëpërmjet postës elektronike.*

Në kuadër të zbatimit të këtij rekomandimi procesi i backup tashmë do të dokumentohet zyrtarisht nga personat përgjegjës”

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar sqarojmë se ASIG ka pranuar konstatimin. Prandaj këto komente nuk merren në konsideratë.

2.3 Siguria e Informacionit

a. Mekanizmat, identifikimi dhe adresimi i risqeve në TIK

Objektivat e auditimit: Të sigurohet se të gjithë risqet e lidhur me sigurinë e informacionit janë identifikuar dhe se ekziston një strategji e përshtatshme për reduktimin e riskut.

Në përmbushje të drejtimit të auditimit “*Mekanizmat, identifikimi dhe adresimi i risqeve në TIK*”, u shqyrtuan dokumentacionet e mëposhtme:

- Strategjia e Menaxhimit të Riskut për Gjeoportalin Kombëtar;
- Rregullore e Gjeoportalit Kombëtar të Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor;
- Rregullore për Administrimin e Sistemit ALBCORS;
- Regjistri i riskut në ASIG.;
- Lista e Rreziqeve për sistemin e Gjeoportalit Kombëtar.

Monitorimi dhe kontrolli i riskut është procesi i identifikimit, analizimit dhe planifikimit për zbulimin e rreziqeve të reja të identifikuara, monitorimit të rreziqeve të identifikuara më parë dhe vlerësimit të atyre ekzistuese për të verifikuar strategjitë e reagimit ndaj rreziqeve të planifikuara për efektivitetin e tyre.

ASIG operon me dy sisteme kryesore, të cilat janë Gjeoportali Kombëtar dhe ALBCORS. Njëkohësisht, administron Gjeoportalin Kombëtar për garantimin e aksesit të publikut dhe subjekteve të interesuara në përputhje me dispozitat e ligjit nr.72/2012 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”. ASIG është përgjegjës për krijimin, mirëmbajtjen dhe përditësimin në përputhje me rregullat e përcaktuara nga institucioni. Gjeoportali Kombëtar kryen përmbledhjen e informacionit gjeohapësinor, të përpunuar dhe të përditësuar nga autoritetet publike sipas temave përkatëse në bazë të nenit 11 të ligjit nr.72/2012.

Institucioni ka hartuar “Strategjinë e Menaxhimit të Riskut për Gjeoportalin Kombëtar” të cilën e ka miratuar në vitin 2019, strategji e cila azhurnohet në varësi të ndryshimeve që pëson risku, në rastet kur ka risqe të reja apo në ato ekzistuese. Institucioni kryen analizën e risqeve gjatë vitit si dhe përcakton impaktin që ato kanë përsa i përket objektivave të institucionit, sidomos ato me risk të lartë të cilat menaxhohen dhe monitorohen në vazhdimësi. Monitorimi i risqeve bëhet në mënyrë që të shmangen rreziqet si një komponent i rëndësishëm për mbarëvajtjen e institucionit.

Sistemi ALBCORS funksionon në përputhje me dispozitat e ligjit nr.72/2012 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë” si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.669, datë 7.8.2013 (i ndryshuar) “Për miratimin e rregullave për përcaktimin, krijimin dhe realizimin e kornizës referuese gjeodezike shqiptare (KRGJSH), si metadata”. ASIG është institucioni përgjegjës për: “Projektimin, ndërtimin, mirëmbajtjen dhe përditësimin e Kornizës Referuese Gjeodezike Shqiptare (KRGJSH). ALBCORS operon në bazë të Vendimit nr.945, datë 02.11.2012, Për miratimin e rregullores “Administrimi i sistemit të Bazave të të Dhënave Shtetërore”, në lidhje me disponueshmërinë, integritetin dhe konfidencialitetin e sistemit.

- ASIG nuk disponon regjistër risku lidhur me sistemin ALBCORS. Në asnjë formë nuk rezultojnë të jenë dokumentuar risqe të identifikuara në periudhën objekt auditimi.

Bazuar në nenin 11, pika 2 “*Identifikimin dhe krijimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë.*”, 12 pika 3/d “*Identifikimin dhe krijimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë*”, nenin 21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 23.10.2015, udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në

njësité e sektorit publik”, i ndryshuar, udhëzimi nr.21, datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”, Udhëzimi i Ministrit të Financave nr.16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësité publike”, ASIG duhet të kishte hartuar regjistrin e riskut ku të përfshihen edhe risqet që lidhen me teknologjinë e informacionit.

1. Titulli i gjetjes: ASIG në hartimin e regjistrit të riskut, për Gjeoportalin Kombëtar nuk ka përcaktuar personin përgjegjës dhe nuk disponon regjistër risku për sistemin ALBCORS.

Situata: Nga auditimi mbi regjistrin e riskut që ka hartuar institucioni, në drejtim të teknologjisë së informacionit, rezultoi se, në asnjë formë nuk janë identifikuar dhe dokumentuar risqe lidhur me sistemin ALBCORS.

Kriteri: Neni 11, pika 2 “Identifikimin dhe krijimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë.”, 12 pika 3/d “Identifikimin dhe krijimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë”, nenin 21 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar me ligjin nr.110/2015, datë 23.10.2015. Neni 21 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar me ligjin nr.110/2015, datë 23.10.2015, udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësité e sektorit publik”, i ndryshuar, udhëzimi nr.21, datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”.

Ndikimi/efekti: Mos identifikim, mos adresim i problematikave që mund të shfaqen në sistemin ALBCORS.

Shkaku: Mospërbushje e dispozitave ligjore.

Rëndësia: E lartë

1.1. Rekomandimi: ASIG të marrë masa për identifikimin dhe dokumentimin e risqeve për sistemin ALBCORS, si pjesë e regjistrit të institucionit në mënyrë që të jenë identifikuar dhe adresuar rreziqet e mundshme që paraqiten në këtë sistem.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me nr.47/8 Prot. datë 23.06.2021, “Mbi Projektraportin e Auditimit” nga z. LÇ ku janë shprehur objeksione si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: “Në regjistrin e riskut është identifikuar si risk mosfunksionimi i sistemit ALBCORS, qendrës së saj të monitorimit dhe stacioneve si pjesë përbërëse të këtij sistemi. Janë parashikuar veprime konkrete për adresimin dhe mënjanimin e risqeve dhe aktualisht kryhet monitorimi i vazhdueshëm i funksionimit të sistemit ALBCORS. Ngritja e grupit të punës për ndjekjen e mirëmbajtjes së sistemit ALBCORS, hartimi i raporteve permanente të funksionimit të tij nga grupi i punës që janë ditore, javore dhe mujore si dhe përditësimi i dokumenteve mbi kontrollin dhe cilësinë e dhënies të shërbimeve.

Megjithatë, ASIG do të zbatojë rekomandimin tuaj dhe do marrë masa për identifikimin, detajimin dhe dokumentimin e risqeve për sistemin ALBCORS, si pjesë e regjistrit të riskut të institucionit në mënyrë që të jenë identifikuar dhe adresuar rreziqet e mundshme që paraqiten në këtë sistem.”

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Nga observacionet rezultoi se ASIG e ka pranuar konstatimin e grupit të auditimit.

2.4. Auditimi i sistemeve

a. Auditimi mbi kontrollet e aplikacioneve dhe të dhënat Input/Output

Objektivi. Vlerësimi i kontrolleve të aplikacionit të Gjeoportalit, për të dhënat Input/Output ka si qëllim të verifikojë kontrollet e implementuara në aplikacion si dhe hyrjen me saktësi të të dhënave dhe raportimin e tyre në funksion të informimit dhe objektivave të institucionit.

Në përmbushje të drejtimit të auditimit “*Auditimi i sistemeve*”, janë shqyrtuar:

- Aktet ligjore/nënligjore/rregullative që përcaktojnë ruajtjen e të dhënave gjeodezike si dhe metadatave etj;
- Standardet Shtetërore për Informacionin Gjeohapësinor në Shqipëri;
- Raportet e auditimit të jashtëm realizuar në periudhën objekt auditimi;
- Manualet e përdorimit të sistemeve;
- Intervista, ndjekja dhe realizimi i proceseve të punës;
- Të dhënat e publikuara në faqen web <http://www.asig.gov.al/>;
- Të dhënat e sistemit të eksportuara për auditim, etj.;

Sipas përkufizimit që i bën ligji, “*GIS Kombëtar*” është Sistemi Kombëtar i Informacionit Gjeohapësinor, i cili përfshin të gjitha sistemet e informacionit gjeografik që ndërtohen për tema të veçanta, në përputhje me standardet e miratuara nga ASIG-u, që ndër veprojnë me njëri-tjetrin dhe që integrohen nga ASIG-u.

Nga auditimi rezulton se edhe pse është në ligjin nr.72/2012, datë 20.7.2012, “*Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë*”, në vendin tonë ende nuk janë të përfshirë në një të vetëm, të gjitha sistemet e informacionit gjeografik të ndërtuara për tema të veçanta, që do të thotë se ende nuk disponojmë një sistem të qendërzuar “*GIS Kombëtar*”, edhe pse janë identifikuar kërkesat dhe specifikat nga ana e ASIG, bazuar në konsulencë dhe në bashkëpunime me institucione homologe nga vende të BE, por dhe nga problematikat që kanë ndeshur në bashkëpunimin me institucionet që kanë detyrim publikimin e temave të caktuara në Gjeoportalin Kombëtar.

Aktualisht Gjeoportali është vetëm një hallkë e GIS Kombëtar, nëpërmjet të cilit sigurohet publikimi i të dhënave gjeohapësinore sipas temave të përcaktuara në ligjin e përmendur më sipër.

I. Sistemi i Gjeoportalit Kombëtar

Auditimi i sistemeve u fokusua në sistemin e “Gjeoportalit” i cili është një “dritare” që i ‘u mundëson vizitorëve dhe përdoruesve, ku nëpërmjet shërbimeve të rrjetit, të kërkojnë, shikojnë dhe aksesojnë informacionin gjeohapësinor të vënë në dispozicion nga autoritetet publike përgjegjëse për mbledhjen përpunimin dhe përditësimin e tij, për secilën nga temat e nenit 11 të ligjit nr.72/2012, datë 20.7.2012, “*Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë*”. Gjeoportali Kombëtar në versionin e tij përfundimtar (realizuar në Shtator 2017) është hapi më i rëndësishëm i ASIG në krijimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor (NSDI), në Shqipëri. Krijimi i tij i shërben qeverisjes dhe të dhënave të hapura, duke ofruar shërbime cilësore dhe larg burokracisë. Qeveria Norvegjeze, nëpërmjet Norwegian Mapping and Cadastre Authority, “SK”, ka financuar zhvillimin e Gjeoportalit Kombëtar dhe ka asistuar e vazhdon të asistojë ASIG, në përmbushjen e misionit të tij.

Baza e të dhënave të Gjeoportalit është miratuar si bazë të dhënash shtetërore dhe ky sistem ndodhet në listën e sistemeve të rëndësishëm nga ALCIRT.

Të dhënat hyrëse në Gjeoportali Kombëtar janë të dhëna të ndërtuara bazuar në Direktivën 2007/2/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 14 mars 2007 “*Për ngritjen e një infrastrukture për informacionin hapësinor në Komunitetin Evropian (INSPIRE)*”. Numri

CELEX: 32007L0002, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, nr.108, datë 25.4.2007, faqe 1 – 14.

Infrastruktura ku hostohet Baza e të Dhënave ndodhet në DataCenter-in që administrohet nga AKSHI.

Gjeoportali Kombëtar është një sistem që mundëson përdoruesit e ndryshëm të institucioneve publike, biznes apo individ të aksesojnë dhe të informohen mbi të dhënat gjeodezike të Republikës së Shqipërisë.

Ky sistem përbëhet nga 4 module:

- Moduli i administrimit të përdoruesve dhe roleve të tyre. Në këtë modul krijohen përdoruesit dhe përcaktohen të drejtat e tyre për aksesimin e portalit dhe shërbimeve që gjenden në të.
- Moduli i administrimit të shtresave të ndryshme gjeografike dhe publikimi i tyre si shërbime. Geoserver dhe GeoWebCache janë komponent që mundësojnë krijimin e shërbimeve GIS dhe publikimin e tyre për t'u përdorur më pas nëpërmjet hartës WebGIS të portalit.
- GeoNetwork – modul i administrimit të metadata-ve për shërbimet e të dhënave gjeografike të publikuara në Gjeoportalin Kombëtar.
- Moduli WebGIS. Ky modul është aplikacioni që mundëson shfaqjen e të dhënave gjeografike, me funksionet standarde të një aplikacioni Web GIS dhe disa funksionalitete specifike si: digjitalizimi i thjeshtë i objekteve në hartë, kërkim i shpejtë dhe i avancuar në hartë, përzgjedhje e objekteve gjeografike.

Gjeoportali Kombëtar aksesohet nëpërmjet faqes web të ASIG, i cili ka një sasi të konsiderueshme vizitorësh, ku vetëm për periudhën me zgjedhje janar 2020, rezulton se vizitorët e faqes web janë dhe nga vende të tjera përveç Shqipërisë siç tregohet dhe në figurën e mëposhtme:


Fig. 4.1: Paraqitja grafike e përdorimit të Gjeoportalit për muajin janar 2020

Country	Users	% Users
1. Albania	11,744	87.49%
2. Italy	440	3.28%
3. Kosovo	392	2.92%
4. United States	149	1.11%
5. Greece	119	0.89%
6. Germany	92	0.69%
7. Hungary	74	0.55%
8. United Kingdom	37	0.28%
9. Switzerland	31	0.23%
10. France	29	0.22%

Burimi: Informacion i përpunuar nga ASIG

Ndërsa faqja web është aksesuar nga afërsisht nga 13,120 përdorues me IP unike, nga të cilët 48.8 % janë vizitorë të rinj dhe 51.2 % vizitorë jo të rinj, siç paraqitet dhe në figurën e mëposhtme:

Fig. 4.2: Paraqitja grafike e përdorimit të Gjeoportalit për muajin janar 2020



Burimi: Informacion i përpunuar nga ASIG

Për periudhën me zgjedhje maj 2019, rezulton se vizitorët e faqes web janë dhe nga vende të tjera përveç Shqipërisë siç tregohet dhe në figurën e mëposhtme:


Fig. 4.3: Paraqitja grafike e përdorimit të Gjeoportalit për muajin maj 2019

Country	Users	% Users
1. Albania	10,574	91.19%
2. Kosovo	259	2.23%
3. Italy	174	1.50%
4. United States	123	1.06%
5. Germany	58	0.50%
6. Greece	49	0.42%
7. United Kingdom	31	0.27%
8. Austria	23	0.20%
9. Croatia	22	0.19%
10. Switzerland	20	0.17%

Burimi: Informacion i përpunuar nga ASIG

Ndërsa faqja web është aksesuar nga afërsisht nga 11,495 përdorues me IP unike, nga të cilët 48 % janë vizitorë të rinj dhe 52 % vizitorë jo të rinj, siç paraqitet dhe në figurën e mëposhtme:

Fig. 4.4: Paraqitja grafike e përdorimit të Gjeoportalit për muajin maj 2019



Burimi: Informacion i përpunuar nga ASIG

Të dhënat që hyjnë në këtë sistem janë të dhëna që gjenerohen nga institucione të ndryshme, ndërsa ASIG është gjenerues i vetëm disa prej tyre, dhe publikues për të gjitha temat e përcaktuara në ligj, detajuar si në tabelën e mëposhtme:

Tabela 4.1: Temat e përcaktuara në ligj për të dhënat gjeohapësinore

Nr.	Tema	Autoriteti Përgjegjës
1	Përcaktimi i kornizës referuese gjeodezike dhe kontrolli gjeodezik	Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG)
2	Sistemet e rrjeteve gjeografike	Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG)
3	Emërtimet gjeografike	Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG)
4	Imazheria e hartës bazë	Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG)
5	Kufijtë e njësive administrative	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV)
6	Sistemi i adresave	Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (DPGJC)
7	Parcelat kadastrale	Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK)
8	Rrjetet e transportit	Instituti i Transportit (IST) Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSH)
9	Hidrografia	Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMVV)
10	Zonat e mbrojtura	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM) Instituti i Monumenteve të Kulturës (IKM)
11	Modeli Dixhital i terrenit	Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG)
12	Mbulesa e tokës	Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM)
13	Ortoimazheria	Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG)

14	Gjeologjia	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH)
15	Njësitë statistikore	Instituti i Statistikave (INSTAT)
16	Ndërtesat	Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK)
17	Pedologjia	Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB) Fushë Krujë
18	Përdorimi i tokës	Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT) Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB) Fushë Krujë
19	Shëndeti i njerëzve dhe siguria e tij	Instituti i Shëndetit Publik (ISHP)
20	Infrastruktura urbane dhe shërbimet qeveritare	Agjencia e Zhvillimit të Territorit (AZHT)
21	Infrastruktura për monitorimin e mjedisit	Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM)
22	Infrastruktura industriale	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
23	Infrastruktura bujqësore dhe akuakultura	Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (AZHBR)
24	Demografia	Instituti i Statistikave (INSTAT)
25	Zonat me përdorim të kufizuar	Agjencia e Zhvillimit të Territorit (AZHT) Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN)
26	Zonat me rreziqe natyrore	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC)
27	Kushtet atmosferike	Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit
28	Meteorologjia	Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit
29	Hidrologjia	Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit
30	Detet	Shërbimi Hidrografik Shqiptar (SHHSH), Komanda e Forcës Detare
31	Zonat ekologjike	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM)
32	Habitatet	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM)
33	Shpërndarja e specieve	Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM)
34	Burimet energjetike	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN)
35	Burimet minerale	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH)

Burimi: Informacion i përpunuar nga audituesit me të dhëna të ASIG


Të dhënat të cilat gjenerohen nga ASIG konsiderohen të dhëna parësore të cilat janë:

- Modeli Dixhital i Terrenit
- Përcaktimi i kornizës referuese gjeodezike dhe kontrolli gjeodezik
- Sistemet e rrjeteve gjeografike
- Ortoimazheria
- Metadatat mbi të dhënat Gjeohapësinore
- Emërtimet Gjeografike
- Imazhi i hartës bazë

Ndërsa, gjithë të tjerat që gjenerohen në të tjera institucione konsiderohen të dhëna dytësore, ndërsa ASIG është institucioni që sipas pikës dh, neni 7, të ligjit nr.72/2012, datë 20.7.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, ka përgjegjësi për administrimin e informacionit gjeohapësinor të mbledhur, të përpunuar dhe të përditësuar nga autoritetet publike sipas temave përkatëse renditur në tabelën e mësipërme.

System flow diagram. Publikimi i të dhënave gjeohapësinore në Gjeoportalin Kombëtar, sipas dokumentit të proceseve të punës e cila shërben dhe si gjurmë audituese, kryhet sipas hapave që nga audituesi është ilustruar nëpërmjet skemës së mëposhtme:

Fig. 4.5: Publikim i të dhënave në Gjeoportali sipas gjurmës audituese



Burimi: Skemë e përpunuar nga audituesit që tregojnë rrugën e publikimit në Gjeoportali

Pra, siç mund të kuptohet dhe nga skema, dokumenti i proceseve të punës i cili shërben dhe si gjurmë audituese në institucion, tregon hapat që ndiqen, ku të dhënat konform standardit publikohen në Gjeoportalin Kombëtar, ndërsa çdo e dhënë tjetër jo konform standardit i komunikohet subjektit me shënimet e nevojshme për të kryer ndryshimet e duhura.

1. Titulli i gjetjes: ASIG nuk disponon paraqitje grafike, apo dokumentim skematik të gjurmës së auditimit si dhe gjurmë digjitale (log) në sistemin e Gjeoportalit .

Situata: Nga auditimi mbi të dhënat, dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion për proceset e punës, rezulton se ASIG nuk disponon paraqitje grafike, apo dokumentim të gjurmës së auditimit (logs) në sistemin e Gjeoportalit.

Gjurma elektronike audituese mbi veprimet që ka kryer çdo përdorues mungon, siguria e të dhënave është bazuar në integritetin e punonjësve, sepse sistemi nuk ofron gjurmë digjitale me qëllim adresimin e saktë të prekjes së të dhënave në rast të ndryshimit të tyre. Ky konstatim bazohet në faktin se fushat e të dhënave “created by” dhe “modified by”, që gjenden në tabelën e roleve, janë “NULL”, çfarë tregon se këto funksionalitete që kanë për qëllim ruajtjen e gjurmës së kryerjes së veprimeve në lidhje me ndryshimet mbi rolet, nuk janë vënë në funksion.

Kriteri: Mungesa e gjurmës është në kundërshtim me rregulloren për menaxhimin e log-eve digjitale në administratën publike miratuar nga Agjencia Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike me urdhrin nr.109, datë 10.06.2016 e cila është detyrim për të gjitha institucionet publike, miratuar me urdhrin nr.109, datë 10.06.2016 nga ALCIRT.

Ndikimi/efekti: Mungesa e gjurmës digjitale është mungesë sigurie, sepse ky element i rëndësishëm garanton ruajtjen e të dhënave nga përdoruesit e brendshëm dhe të jashtëm të sistemit.

Shkaku: Mos zbatim i urdhrin nr.109, datë 10.06.2016 nga ALCIRT.

Rëndësia: E lartë

1.1 Rekomandimi: ASIG të marrë masa, për përmirësimin e bazës së të dhënave në drejtimin e ruajtjes dhe sigurimit të gjurmës digjitale në zbatim të urdhrin nr.109, datë 10.06.2016, duke

e konsideruar në termat e mirëmbajtjes të ofruar nga operatorë të jashtëm apo nga AKSHI, me konsideratën që zgjidhja të suportojë zhvillimet në drejtim të sistemit të GIS-it Kombëtar, për të cilin është menduar të përdoret e njëjta bazë të dhënash bazuar në faktin që është një bazë të dhënash shtetërore.

Në ligjin nr.72/2021, datë 28.06.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në republikën e Shqipërisë”, përcakton në nenin 5 të tij, strukturën kombëtare të informacionit gjeohapësinor ku thuhet se:

1. Autoritetet kombëtare përgjegjëse për informacionin gjeohapësinor janë ASIG, Bordi i Informacionit Gjeohapësinor (BIG) dhe autoritetet publike përgjegjëse për mbledhjen, përpunimin dhe përditësimin e informacionit gjeohapësinor, sipas legjislacionit në fuqi.

2. ASIG-u është institucion vendimmarrës, ekzekutiv dhe koordinues që mbikëqyr zbatimin e këtij ligji dhe të akteve nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij.

3. BIG-u është organ këshillimor që ushtron veprimtarinë e tij me kohë të pjesshme dhe mbledhet sa herë që është e nevojshme, për realizimin e veprimtarisë së përcaktuar sipas pikës 2 të nenit 10 të këtij ligji.

4. Autoritetet publike përgjegjëse për mbledhjen, përpunimin dhe përditësimin e informacionit gjeohapësinor janë autoritetet e parashikuara në pikën 2 të nenit 3 të këtij ligji, të cilat, sipas legjislacionit në fuqi, ngarkohen me këto përgjegjësi.

Nga auditimi konstatohet se përditësimi i të dhënave që kanë ndryshuar janë përgjegjësi e institucionit që e disponon atë të dhënë dhe e gjeneron si të dhëna parësore.

Pjesa më e madhe e përditësimit ndodh manualisht pra të dhënat në trajtë elektronike dorëzohen në ASIG me USB/CD/DVD, ndërsa një pjesë e vogël shërbimesh e kryen përditësimin nëpërmjet webservice, dhe këto të fundit janë:

Tabela 4.2: Shërbime që përditësohen nëpërmjet webservice

Shtresa	Institucioni
Zonat Kadastrale (ALBSReP)	Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK)
Ndërtesat (ALBSReP)	Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK)
Parcelat (ALBSReP)	Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK)
Ndërtesat (ASHK)	Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme
Zonat e Mbrojtura	Instituti i Monumenteve të Kulturës
Monumente kulture -Poligon	Instituti i Monumenteve të Kulturës
Monumente kulture -Pike	Instituti i Monumenteve të Kulturës
DRKK	Instituti i Monumenteve të Kulturës

Burimi: Informacion i përpunuar nga audituesit me të dhëna të ASIG

Klasat e dokumenteve burimorë. 34 klasat e dokumenteve burimorë janë përcaktuar në ligjin nr.72/2012, datë 20.7.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë” ku bazuar në nenin 11, pika 2 janë përmendur në tabelën 1, renditur me institucionet përkatëse.

Secila prej tyre gjeneron të dhëna për më shumë se 1 shtresë ku në total numri i shtresave që kërkohet të gjenerohen nga këto klasa sipas të dhënave që na janë vënë në dispozicion shkon në 236, numër që mund të rritet nëse shtohen informacione të reja. Mungesa e të dhënave për një klasë burimore tregon se mungojnë të dhënat për shtresat respektive të asaj klase.

Metadatat mbi të dhënat e Gjeoportalit publikuar në web tregojnë se konform standardit Shtetëror për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri, janë të dhënat mbi:

1. Zonat e Mbrojtura (Monumente Kulture);
2. Monumente Kulture, Poligon;
3. Monumente Kulture, Pikë;
4. Nomenklatura e Hartës (1 :2500);
5. Nomenklatura e Hartës (1 :5000);
6. Nomenklatura e Hartës (1 :10000);
7. Nomenklatura e Hartës (1 :25000);
8. Nomenklatura e Hartës (1 :50000);
9. Nomenklatura e Hartës (1 :100000);
10. Emërtime Gjeografike 2018;
11. Mbulesa e Tokës Corine 2018;
12. Basenet;
13. Rrjeti i rrjedhës ujore;
14. Pellg ujëmbajtës;
15. Rrjedhë ujore;
16. Ligatinë;
17. Zonat kadastrale të sistemit ALBSRep;
18. Ndërtesat të sistemit ALBSRep;
19. Parcelat në sistemin ALBSRep;
20. Modeli Dixhital i Sipërfaqes (DSM 2015- 2017) 3D;
21. Modeli Dixhital i Sipërfaqes (DSM 2015- 2017) 3D;
22. Modeli Dixhital i Terrenit, Izoipse;
23. Imazhi i hartës bazë;
24. Ortoimazheria;
25. Kufijtë e njësive administrativë;

Ndërsa të dhënat, të cilat nuk janë konform standardit Shtetëror për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri, bazuar dhe në Metadatat përkatëse të çdo shtrese, janë publikuar në Gjeoportali të dhënat që ndodhet në Aneks.

Nga auditimi mbi të dhënat që nuk janë konform standardit të miratuar si më sipër, u konstatua se, ASIG nuk iu është drejtuar institucioneve me qëllim vënien në dijeni për mungesën e konformitetit, me qëllim plotësimin dhe saktësimin e tyre përpara se të publikohen në Gjeoportali dhe në respektim të hapave që vetë ASIG ka miratuar në proceset e punës;

Në të gjitha rastet ku data më e fundit e publikimit të të dhënës është pas datës së miratimit të aktit ligjor që përcakton rregullat për saktësimin dhe publikimin e saj, tregon se kemi të bëjmë me mos respektim të standardeve nga ana e institucioneve të cilat e kanë detyrimin si dhe nga ana e ASIG, që ka detyrim publikimin e tyre.

Kontrolli mbi përputhshmërisë me standardin nga ana e ASIG, për të dhënat që depozitojnë institucionet, kryhet për këto drejtime:

1. Kontrolli i sistemit koordinativ referencë;
2. Kontrolli i strukturës emërtimeve dhe numrit të tipologjive;
3. Kontrolli i strukturës emërtimeve dhe numrit të attributeve;
4. Kontrolli i katalogut të tipologjisë;
5. Kontrolli i metadatave;
6. Kontrolli i cilësisë së të dhënave;

Nga ky kontroll identifikon nëse nuk është plotësuar një apo më shumë nga pikat e mësipërme.

Rrjetet e Transportit, Infrastruktura rrugore (ARRSH), nuk janë konform standardit në lidhje me: 3. Kontrolli i strukturës emërtimeve dhe numrit të atributiveve; 4. Kontrolli i katalogut të tipologjisë; 6. Kontrolli i cilësisë së të dhënave;

AMBU, Lejet për Hydrocentrale, me institucion gjenerues Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMVV), nuk janë konform standardit në lidhje me: 2. Kontrolli i strukturës emërtimeve dhe numrit të tipologjive; 3. Kontrolli i strukturës emërtimeve dhe numrit të atributiveve; 4. Kontrolli i katalogut të tipologjisë; 6. Kontrolli i cilësisë së të dhënave;

- AMBU, Përdorimi i ujit, me institucion gjenerues Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMVV), nuk janë konform standardit në lidhje me: 2. Kontrolli i strukturës emërtimeve dhe numrit të tipologjive; 3. Kontrolli i strukturës emërtimeve dhe numrit të atributiveve; 4. Kontrolli i katalogut të tipologjisë; 6. Kontrolli i cilësisë së të dhënave;

- AMBU, Inbotilim, me institucion gjenerues Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMVV), nuk janë konform standardit në lidhje me: 2. Kontrolli i strukturës emërtimeve dhe numrit të tipologjive; 3. Kontrolli i strukturës emërtimeve dhe numrit të atributiveve; 4. Kontrolli i katalogut të tipologjisë; 6. Kontrolli i cilësisë së të dhënave;

- AMBU, Pus shpimet, me institucion gjenerues Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMVV), nuk janë konform standardit në lidhje me: 2. Kontrolli i strukturës emërtimeve dhe numrit të tipologjive; 3. Kontrolli i strukturës emërtimeve dhe numrit të atributiveve; 4. Kontrolli i katalogut të tipologjisë; 6. Kontrolli i cilësisë së të dhënave;

Ndërtesat (ASHK), me institucion gjenerues Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), nuk janë konform standardit në lidhje me: 3. Kontrolli i strukturës emërtimeve dhe numrit të atributiveve; 4. Kontrolli i katalogut të tipologjisë; 6. Kontrolli i cilësisë së të dhënave;

2. Titulli i gjetjes: Të dhëna të publikuara në Gjeoportalin Kombëtar, të cilat nuk janë konform standardit për të dhënat dhe metadatën.

Situata:

1. Nga auditimi mbi të dhënat e publikuara në Gjeoportalin Kombëtar rezultuan se disa prej të dhënave nuk janë konform standardit të miratuar, por janë publikuar në Gjeoportali me shënimin “Të dhëna jo konform standardit...”, renditur si më poshtë:

- Rrjetet e Transportit, Infrastruktura rrugore (ARRSH), për: strukturën e emërtimeve dhe numrit të atributiveve, katalogut të tipologjisë dhe cilësisë së të dhënave;

- AMBU, Lejet për Hydrocentrale, me institucion gjenerues Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMVV), për: strukturën e emërtimeve dhe numrit të tipologjive, strukturën e emërtimeve dhe numrit të atributiveve, katalogut të tipologjisë dhe cilësisë së të dhënave;

- AMBU, Përdorimi i ujit, me institucion gjenerues Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMVV), për: strukturën e emërtimeve dhe numrit të tipologjive, strukturën e emërtimeve dhe numrit të atributiveve, katalogut të tipologjisë dhe cilësisë së të dhënave;

- AMBU, Inbotilim, me institucion gjenerues Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMVV), për: strukturën e emërtimeve dhe numrit të tipologjive, strukturën e emërtimeve dhe numrit të atributiveve, katalogut të tipologjisë dhe cilësisë së të dhënave;

- AMBU, Pus shpimet, me institucion gjenerues Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMVV), për: strukturën e emërtimeve dhe numrit të tipologjive, strukturën e emërtimeve dhe numrit të atributiveve, katalogut të tipologjisë dhe cilësisë së të dhënave;

- Ndërtesat (ASHK), me institucion gjenerues Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për: strukturën e emërtimeve dhe numrit të atributiveve, katalogut të tipologjisë dhe cilësisë së të dhënave;

2. Nga auditimi u konstatua se janë publikuar pa informacionin Gjeohapësinor (metadatën):

- Përdorimi i Tokës (Zona e mbulimit);

- Tipet e Tokës (Zona e mbulimit);

Kriteri: VKM nr.1077, datë 23.12.2015 “për miratimin e rregullores “për krijimin, ruajtjen dhe përditësimin e metadatave, strukturën e katalogimit dhe afatet e krijimit të metadatave specifike për çdo temë”; si dhe standardet për secilën shtresë.

Ndikimi/efekti: Publikimi i një informacioni jo të përditësuar dhe konform standardeve shtetërore, për secilën prej tyre.

Shkaku: Mungesë bashkëpunimi ndërmjet institucioneve

Rëndësia: E lartë

2.1 Rekomandimi: ASIG si institucion standardizues dhe publikues i të dhënave Gjeohapësinore të marrë masa kontrolluese dhe kundërshtuese për mos publikimin e të dhënave hapësinore në rastet kur metadata nga institucioni dërgues mungon, si e vetmja mënyrë, për të parandaluar publikimin e informacioneve jo të plota gjeohapësinore.

2.2 Rekomandimi: ASIG si institucion përgjegjës, për respektimin e standardeve gjeohapësinore, të respektojë hartën e proceseve të punës duke i kthyer përgjigje çdo subjekti me të dhëna të detajuara mbi parregullsitë e konstatuara nga kontrollet e konformitetit.

2.3 Rekomandimi: ASIG si institucion përgjegjës, për respektimin e standardeve gjeohapësinore, të respektojë hartën e proceseve të punës duke i kthyer përgjigje çdo subjekti me të dhëna të detajuara mbi parregullsitë e konstatuara nga kontrollet e konformitetit.

2.4 Rekomandimi: ASIG në bashkëpunim me institucionin përgjegjës të plotësojnë metadatën për të dhënat gjeohapësinore të shtresave:

- Përdorimi i Tokës (Zona e mbulimit);
- Tipet e Tokës (Zona e mbulimit);

Të dhëna të paregjistruara. Institucione të cilat nuk kanë sisteme, por kanë detyrimin të dërgojnë informacion konform standardeve në ASIG, i ‘u është vënë në dispozicion një opsion nëpërmjet Gjeoportalit ti regjistrojnë lokalisht të dhënat e kërkuara, të cilat nuk transferohen dhe ruhen në sistemin e Gjeoportalit, por vetëm në përdorimin e tyre individual.

Nisur nga rëndësia e përthithjes së informacionit gjeohapësinor nga institucionet që nuk kanë struktura dhe infrastruktura teknologjike, opsioni i regjistrimit nga vetë institucioni është i rëndësishëm. Por, në këtë mënyrë ASIG nuk e merr informacionin e nevojshëm sepse të dhënat lokale nuk ruhen dhe nuk bëhen publike. Të dhënat nevojitet të hidhen lokalisht më shumë se një herë sepse nuk lexohen nga sistemi qendror “Gjeoportali”, vetëm përdoruesi që i ka regjistruar mund ti përdorë ato lokalisht dhe askush tjetër.

3. Titulli i gjetjes: Të dhëna gjeohapësinore që nuk janë publikuar për disa grupe që përcakton ligji.

Situata: Nga auditimi mbi të dhënat e publikuara në Gjeoportalin kombëtar rezulton se, mungojnë të dhënat gjeohapësinore dhe metadatat, për temat dhe autoritetin përgjegjës në tabelën më poshtë:

Nr.	Tema	Autoriteti Përgjegjës
1	Pedologjia	Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB)
2	Shëndeti i njerëzve dhe siguria e tyre	Instituti i Shëndetit Publik (ISHP)
3	Infrastruktura industriale	Ministria e Industrisë dhe Energjetikës (MIE) Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN)
4	Infrastruktura bujqësore dhe akuakultura	Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR)
5	Zonat me përdorim të kufizuar	Agjencia e Zhvillimit të Territorit (AZHT) Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM)
6	Zonat me rreziqe natyrore	Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile

7	Kushtet atmosferike	Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit
8	Meteorologjia	Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit
9	Hidrologjia	Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit
10	Detet	Shërbimin Hidrografik Shqiptar (Komanda e Forcave Detare)
11	Zonat ekologjike	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM)
12	Habitatet	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM)
13	Shpërndarja e specieve	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM) Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM)

Kriteri: 34 klasat e dokumenteve burimorë janë përcaktuar në ligjin nr.72/2012, datë 20.7.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë” neni 11, pika 2.

Ndikimi/efekti: Pamundësi për të gjetur informacion gjeohapësinor si dhe institucionet përgjegjëse që e disponojnë, por që nuk i është vënë në dispozicion ASIG.

Shkaku: Mungesa e informacionit digjital, për rubrikat që kanë detyrim këto institucione.

Rëndësia: E lartë

3.1 Rekomandimi: ASIG në bashkëpunim me autoritet përgjegjëse për temat e mësipërme që zotërojnë informacione gjeohapësinore, e që ende nuk janë publikuar në Gjeoportalin Kombëtar, të cilat janë:

- Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB);
- Instituti i Shëndetit Publik (ISHP);
- Ministria e Industrisë dhe Energjetikës (MIE);
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM);
- Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN);
- Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR);
- Agjencia e Zhvillimit të Territorit (AZHT);
- Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM);
- Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile;
- Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit;
- Shërbimin Hidrografik Shqiptar (Komanda e Forcave Detare);
- Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM);

Të iniciojnë procesin e publikimit të informacionit, pra metadatën përkatëse, si një e drejtë e informimit, për të dhënat të cilat jo vetëm që janë parashikuar në aktet ligjore por nuk do të kenë së shpejti ndonjë sistemi informatik.

ASIG-u është autoriteti përgjegjës për ngritjen e GIS-it Kombëtar, në përputhje me standardet dhe rregullat e miratuara sipas pikës 1 të nenit 16 të këtij ligji. Për këtë ASIG ka përgatitur me asistencën e Autoritet Hartografik Norvegjez- SK, projektin teknik në lidhje me ndërtimin e GIS Kombëtar me të cilin u njoh dhe grupi i auditimit.

ASIG, në zbatim të Ligjit 72/2012 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, në planifikim buxhetor afatmesëm 2016-2018 ka parashikuar në planin e investimeve, projektin për ndërtimin e GIS - Kombëtar duke filluar fillimisht me projektimin e GIS-it Kombëtar dhe me pas me implementim e tij. Gjate këtyre viteve, Ministria e Financave dhe Ekonomisë nuk ka miratuar projektin e investimit të parashikuar nga ASIG, për ndërtimin e GIS-it Kombëtar me arsyen e pamjaftueshmërisë së fondeve që kërkonte implementimi i këtij projekti. Gjatë vitit 2019, projektimi i GIS-it Kombëtar është realizuar nëpërmjet financimit nga donatori, SK.

Rregulla mbi vlefshmërinë. Në sistemin e Gjeoportalit, nuk janë implementuar kontrole mbi vlefshmërinë e të dhënave të regjistruara (*validation rule*), ndërkohë që përputhshmëria me standardin verifikohet manualisht, çfarë e bën procesin më të vështirë dhe jo të garantuar.

Vlefshmëria e të dhënave nuk është zhvilluar në aplikacionin e Gjeoportalit, por është konsideruar në projektin teknik të GIS-it Kombëtar, meqenëse dhe nga eksperiencia është parë e nevojshme.

Nga auditimi konstatuam se në sistemin e Gjeoportalit nuk është mundësuar implementimi i standardeve që ASIG në bashkëpunim me institucionet respektive ka miratuar, sipas të cilëve të ndërtohen kontrole të automatizuara me qëllim shmangien e kontroleve manuale mbi plotësinë dhe konformitetin e të dhënave.

Gjithashtu të dhënat e institucioneve që janë importuar, nuk i 'u janë përmbajtur emërtimeve të të dhënave sipas standardit sepse baza e të dhënave për çdo skemë nuk përmban informacionet detyruese të standardit, por rekordi importohet me informacionin dhe emërtimin e fushave që i ka dhënë vetë subjekti dërgues.

Input Control. Kontrolli mbi regjistrimin e të dhënave nuk është zhvilluar në aplikacionin e Gjeoportalit, por është konsideruar në projektin teknik të GIS-it Kombëtar, që kjo të realizohet nëpërmjet sistemit që në momentin e regjistrimit nga ana e subjekteve përgjegjëse. Nga analizimi i disa prej të dhënave tregojnë se mungojnë kontrole të input-it të të dhënave që do të thotë se mund të regjistrohen të dhëna me mangësi, si:

- Në tabelën *adr_ndertese*: ka të dhëna që ju mungon emri i rrugës, kur është populluar kodi i rrugës apo *shape_area*;
- Mungon informacioni nëse ndërtesa apo prona është publike apo private;
- Nuk janë standardizuar shkrimi i të dhënave unike si emrat e qyteteve, emrat e prefekturave, nënprefekturave, emrat e muajve të vitit. Këto të dhëna rezultojnë herë të shkruara me "e" dhe herë me "ë". Të shkruarit në këtë mënyrë krijon pengesa në filtrime të të dhënave dhe grupime të zonave të njëjta apo të njëjtën nënprefekturë, apo në të njëjtin muaj si dhe analiza të tjera të nevojshme sipas rastit.
- Zona kadastrale nuk ka informacion tregues për datën e fundit në të cilën është prekur apo ka ndryshuar zona, apo një pronë e caktuar.

4. Titulli i gjetjes: Mungesë e kontroleve automatike dhe të vlefshmërisë së të dhënave që regjistrohen si "*input*" në sistemin e Gjeoportalit, parashikuar në specifikat teknike të sistemit të "GIS Kombëtar".

Situata: Nga auditimi mbi kontrollet e implementuara në sistemin e Gjeoportalit Kombëtar u konstatuan mangësi në drejtim të identifikimit dhe saktësisimit, si:

- Nuk jepet informacion nëse ndërtesa ose prona është publike apo private çfarë i shërben informacionit më të detajuar dhe më të plotë të përdoruesve të portalit;
- Mungon standardizimi i shkrimit për të dhëna unike si emrat e qyteteve, emrat e prefekturave, nënprefekturave, emrat e muajve të vitit etj., çfarë krijon pengesa për raportime dhe statistika të ndryshme që vetë institucionit mund ti nevojiten;
- Të dhënat e institucioneve që janë importuar në sistem, nuk i 'u janë përmbajtur emërtimeve të të dhënave sipas standardit sepse baza e të dhënave për çdo skemë nuk përmban informacionet detyruese të standardit, por rekordi importohet me informacionin dhe emërtimin e fushave që i ka dhënë vetë subjekti dërgues. Prezenca e të dhënave jo të plota dhe mungesa e përcaktimit të të dhënave detyruese për çdo klasë të dhënash, ka krijuar mundësinë e regjistrimit të të dhënave jo të plota, si në rastin e tabelës *adr_ndertese*: ka të dhëna që ju mungon emri i rrugës, kur është populluar kodi i rrugës apo *shape_area*;

Kriteri: Praktikat me të mira, në lidhje me parametrizimin e bazave të të dhënave në sistemet e informacionit.

Ndikimi/efekti: Ulje të efektivitetit të përdorimit Gjeoportalit Kombëtar, ulje të imazhit

Shkaku: Standardet e miratuara për të dhënat që hyjnë në sistem, janë standarde që kërkohen të implementohen nga institucionet, por nuk është cilësuar dhe siguruar se e njëjtën përmbajtje

e detyrueshme duhet të regjistrohet dhe në sistem, ndërsa të dhënat shtesë të insertohen në bazën e të dhënave, por jo duke qenë të detyrueshme.

Rëndësia: E lartë

4.1 Rekomandimi: ASIG në bashkëpunim me autoritetet përgjegjëse që gjenerojnë informacion për secilën temë, të marrin në konsideratë sistemit e bazës së të dhënave në lidhje me:

- Shtimin e informacionit nëse ndërtesa ose prona është publike apo private nga adresari apo ASHK, për ato raste kur ky informacion është publik dhe pa pagesë;
- Standardizimi i shkrimit për të dhëna unike si emrat e qyteteve, emrat e prefekturave, nënprefekturave, emrat e muajve të vitit etj.;
- Plotësimin dhe sigurimin e të dhënave që përcaktojnë standardet për çdo klasë, ku më parë të jenë përcaktuar se cilat janë të dhënat detyruese dhe cilat janë të dhënat plotësuese që kërkohen të plotësojnë subjektet për publikimin e informacionit gjeohapësinor.

Përdoruesit e sistemit. Nga auditimi rezulton se të drejtat e përdoruesve në sistemin e Gjeoportalit janë bazuar në role “*role based*”, të drejtat e tyre nuk ndryshojnë nga përdoruesi në përdorues, por vetëm në bazë roli. Në çdo rast ndryshimet pasqyrohen tek roli të cilat më pas i reflektohen automatikisht një apo disa përdoruesve që kanë rolin e ndryshuar duke qenë kështu në përputhje me praktikën më të mira për administrimin e përdoruesve.

Rolet kryesore në sistem grupohen në dy kategori kryesore:

- View-të drejtë për të lexuar;
- Download- të drejtë për të download-uar;

Nga auditimi rezultoi se janë krijuar “*role*” me të drejta të kufizuara për shtresa të caktuara, të cilat nuk janë dokumentuar. Dokumentimi i parametrizimeve që kryejnë përdoruesit e brendshëm në sistem është i rëndësishëm sepse garanton gjurmën e auditimit.

Gjithashtu rezultuan aktive role të krijuara për testime si “*ROLE_TEST*” apo që nuk kanë asnjë adresim të drejtash si “*ROLE_VIEWER_ADMIN*”.

Nëpërmjet ndërfaqes web është krijuar mundësia që të krijohen llogari përdoruesi për aksesimin e Gjeoportalit të cilit mund të hyjnë jo vetëm duke regjistruar të dhënat e kërkuara, por dhe nëse disponojnë një llogari në e-albania.

Sa i takon administrimit të përdoruesve u konstatuan në disa raste më shumë se 1 përdorues i regjistruar me adresa të ndryshme emali, për të njëjtin person të cilët subjekti argumenton se janë krijuar, për të kryer testime të ndryshme. Këta përdorues rezultojnë ende aktiv edhe pas përfundimit të testeve nga të cilët 3 përdorues i përkasin OE që ka kryer mirëmbajtjen e sistemit, për të cilin kontrata ka përfunduar.

Miratimi i kërkesave për download të informacionit të kërkuar është një proces miratimi që kryhet rast pas rasti, ndërkohë që për përdoruesit e identifikuar me llogarinë nga e-albania, opsioni i download-imit është një e drejtë për çdo përdorues, pavarësisht se ai përfaqëson një individ privat. Ky problem është konstatuar nga vetë ASIG dhe në bashkëpunim me AKSHI do të ndiqet këtë problem në kontratën e ardhshme të mirëmbajtjes së Gjeoportalit.

Përdoruesit rezultojnë të grupuar si përdorues *të brendshëm* dhe *të jashtëm*.

- Përdorues të brendshëm janë vetë punonjësit e institucionit;
- Përdoruesit e jashtëm me të drejta download-imi janë të gjithë punonjësit që regjistrohen me shkresë zyrtare drejtuar institucionit që janë punonjës të institucioneve shtetërore.

Grupi i auditimit kreu testime mbi krijimin e përdoruesit nga ndërfaqja e internetit: <https://geoport.al/cas/login> me qëllim identifikimin dhe verifikimin e formës së krijimit dhe përdorimit që i ofrohet përdoruesit. Hapat e ndjekur sipas manualit janë si më poshtë:

Fig. 4.6: Krijimi i përdoruesit nga WEB

Gjeoportali Kombëtar i ASIG
Vendosni emrin e përdoruesit dhe fjalëkalimin për të hyrë në Gjeoportalin Kombëtar

Ju lutem plotësoni [Shqip](#) | [English](#)

Emri i përdoruesit:

Fjalëkalimi:

HYR FSHIJ

[Hyr nga e-albania](#) | [Krijoni një llogari](#) | [Harrova fjalëkalimin](#)

Për arsye sigurie, [dihni](#) nga shfletuesi juaj kur të jeni duke aksesuar në shërbime që kërkojnë autentifikim!

Regjistrimi i përdoruesit

Emri i përdoruesit:

Fjalëkalimi:

E-mail:

Emri:

Mbiemri:

Adresa:

Qyteti:

Kodi postar:

Shteti:


Numri i telefonit:

Numri i telefonit mobil:

Institution:

Institution publik:

Pozicioni i punës:


I'm not a robot 

Regjistrohuni

Burimi: Testime nga audituesit për krijimin e përdoruesit nga web

Opsioni “Hyr nga e-albania” është opsioni ku çdo përdorues mund të hyjë nëse ka një llogari të krijuar më parë në e-albania. Si përdorues, testuam opsionin “Krijoni një llogari”. Butoni “**Regjistrohu**” nuk bëhet aktiv nëse nuk janë plotësuar të dhëna e: emrit, përdoruesit fjalëkalimit dhe adresës së e-mailit dhe institucioni meqenëse në rastin tonë kemi zgjedhur opsionin institucion publik; ndërsa elementët e tjerë me sa duket nga testimet, por dhe në manualin e përdoruesit të sistemit, nuk janë të detyrueshëm për hapjen e llogarisë. Llogaria nuk arriti të krijohet dhe pamja e ndërfaqes ishte si në figurën më poshtë:

Fig. 4.7: Rezultati i testimit



5. Titulli i gjetjes: Parregullsi të konstatuara në identifikimin dhe administrimin e përdoruesve të brendshëm punonjës të ASIG si dhe të përdoruesve të jashtëm privat dhe publik.

Situata: Nga auditimi mbi të dhënat e përdoruesve rezultoi se:

- Janë krijuar më shumë se 1 përdorues për të njëjtin punonjës, përfshirë dhe punonjësin e firmës që ka ofruar mirëmbajtjen dhe rezultojnë aktivë edhe pse respektivisht testimet e punonjësve të brendshëm kanë përfunduar dhe kontrata e mirëmbajtjes.
- Mungon identifikimi i përdoruesve nëse ai është punonjës publik apo privat, si një ndarje e rëndësishme e cila i shërben analizimit të të dhënave dhe vlerësimit mbi përdorimin e sistemit të Gjeoportalit Kombëtar.
- Nuk janë përcaktuar fushat e detyrueshme në formën e krijimit të përdoruesit nëpërmjet web-it, në mënyrë që vetë përdoruesi të kuptojë rëndësinë e plotësimit të tyre kur kërkon të krijojë një përdorues të sistemit të Gjeoportalit nëpërmjet web-it.

Kriteri: Praktikrat më të mira për krijimin dhe administrimin e përdoruesve të sistemit.

Ndikimi/efekti: Pamundësi për të identifikuar dhe analizuar përdoruesit e sistemit dhe ngarkesën që ata krijojnë në sistem si rezultat i kërkimit të informacionit, pengesa në krijimin e përdoruesit nëse ai nuk informohet se cilat janë të dhënat detyrim për krijimin e përdoruesit, risk në të dhënat nga përdorues të paautorizuar.

Shkaku: Mangësi të sistemit dhe mungesë zhvillimi në këtë drejtim.

Rëndësia: E lartë

5.1 Rekomandimi: ASIG të marrë masa për:

- Të hartojë e zbatojë rregulla të mirë përcaktuara mbi të drejtat dhe detyrimet që kanë përdoruesit e brendshëm dhe të jashtëm si përdorues të sistemit.
- Identifikimin e saktë nëse përdoruesit janë të brendshëm, të institucioneve publike apo privat;
- Të identifikojë dhe ti sinjalizojë me simbole të dukshme të dhënat e detyrueshme në formën e krijimit të përdoruesit nga web.

Kodi në burim. Nga auditimi rezulton se “kodi në burim” është dokumentuar tek ASIG, ndërsa kodi në burim për ndryshimet që janë kryer gjatë mirëmbajtjes së sistemit është dokumentuar tek AKSHI, si institucioni që ka zhvilluar dhe procedurën e prokurimit të mirëmbajtjes së sistemit, për një periudhë 2 vjeçare e cila tashmë ka përfunduar. ASIG si institucion teknik këshillimor dhe administrues i të dhënave gjeohapësinore, i cili për administrimin e tyre ka ndërtuar një sistem “Gjeoportalin Kombëtar”, nuk e ka transferuar sistemin si aset tek AKSHI me argumentimin se ligji i cili përcakton ASIG si administrator të të dhënave nuk do të quhej i zbatuar nëse zbatonim VKM nr.673, datë 22.11.2017, “Për riorganizimin e agjencisë kombëtare të shoqërisë së informacionit”, i ndryshuar. Në një situatë ende të pazgjidhur për të

cilën ASIG i është drejtuar për interpretim Sekretarit të Përgjithshëm në KM, sistemi i Gjeoportalit Kombëtar nuk rezulton në mirëmbajtje nga të tretë edhe pse ASIG nuk ka në strukturën e tij asnjë pozicion “Specialist IT”. Problematikat dhe investigimet e problematikave të konstatuara në sistem, janë identifikuar nga punonjësit e vetë ASIG të cilët e njohin sistemin qoftë si përdorues qoftë si implementues prej fillimit, por kjo nuk garanton funksionimin e sistemit në çdo rast që mund të jetë e nevojshme.

Manualet e përdoruesve. Nga auditimi u konstatuan se rezultojnë të dokumentuar manualet e përdoruesve, të cilët i kanë shërbyer dhe operatorit ekonomik që ka kryer mirëmbajtjen duke patur parasysh që zhvilluesi i sistemit ka qenë një operator Kroat.

Metadata. Sipas përkufizimit që i jep ligji nr.72/2012, datë 20.7.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, “Metadata” është informacioni që përshkruan të dhënat, grupet e të dhënave gjeohapësinore dhe shërbimet që lidhen me to, të cilat mundësojnë zbulimin, inventarizimin dhe përdorimin e të dhënave gjeohapësinore. Ky informacion organizohet dhe bazohet sipas VKM nr.1077, datë 23.12.2015 “Për krijimin, ruajtjen dhe përditësimin e metadatave, strukturën e katalogimit dhe afatet e krijimit të metadatave specifike për çdo temë”. Metadata është një e dhënë parësore për bazën e të dhënave të ASIG, dhe si e tillë detyrimi për plotësimin e saj është në ASIG.

Fig. 4.8: Informacioni i shtresëzuar



Udhëzuesin si dhe shpjegime mbi modelin dhe përdorimin e metadatave, çdo përdorues mund ta gjejë në linkun:


<https://geoportal.asig.gov.al/sq/node/226> .

Përdoruesit e Gjeoportalit mund të informohen me detaje në kategorinë “Informacion” të çdo shtrese që është publikuar në portal, siç shpjegohet dhe në manualin e përdoruesit që gjendet po në web në linkun:

https://geoportal.asig.gov.al/sites/default/files/2017-08/ASIG_Geoportal-Manual_perdoruesi.pdf

Fig. 4.9: Të dhënat e dukshme me hapjen e Informacionit të shtresëzuar





Burimi: Informacioni gjendet tek çdo shtresë e Gjeoportalit

Nëse përdoruesit do të duan më shumë informacion, mund ta gjejnë nëse klikojnë “[Pamje në katalog](#)”, një emërtim ky jo i përshtatshëm për të treguar se në të gjenden më shumë detaje.

Detajet mbi Metadatat dërgohen nga subjektet që sjellin të dhënat, sipas një modeli në excel i ndërtuar me përmbajtjen e të dhënave sipas shtresave të caktuara, miratuar me VKM nr.1077, datë 23.12.2015 “*Për krijimin, ruajtjen dhe përditësimin e metadatave, strukturën e katalogimit dhe afatet e krijimit të metadatave specifike për çdo temë*”.

Këto të dhëna të marra nga subjekti regjistrohen një nga një manualisht në sistem meqenëse kontrolli, plotësimi dhe detyrimi i Metadatës është përgjegjësi e ASIG, pasi kjo e dhënë është një e dhënë parësore në sistemin e Gjeoportalit.

Nga ana vizuale “Informacioni” nuk tregon dukshëm dhe në mënyrë të zgjedhur informacion për lexuesin, si prsh: institucioni nga e cila kjo e dhënë buron, konformiteti etj. Në rastet e institucioneve që nuk kanë përditësuar informacionin gjeohapësinor, Informacioni të dalë aktiv kur sapo përdoruesi të zgjedhë shtresën, duke i dhënë mundësinë përdoruesit të lexojë së pari metadatën për këtë shtresë e më pas të mund të navigojë.

Fakti që në plotësimin e metadatave konstatohen më shumë se një problematikë, kjo tregon se kësaj fushe nuk i është dhënë rëndësia e duhur nga ana e ASIG.

Grupi i auditimit konstaton se jo në të gjitha problematikat e konstatuara, përgjegjësi është e ASIG dhe punonjësve të këtij institucioni, por roli i këtij institucioni është ndikues dhe i rëndësishëm në përmirësimin e çështjeve të konstatuara.

6. Titulli i gjetjes: Nga auditimi mbi të dhënat e popullimit të metadatës, u konstatuan disa problematika që nuk janë në përputhje me VKM nr.1077, datë 23.12.2015.

Situata: Nga auditimi mbi të dhënat e popullimit të metadatës nga ASIG, u konstatuan disa problematika të cilat tregojnë për parregullsi në plotësimin e një informacioni kaq të rëndësishëm siç është metadata e informacionit gjeohapësinor për faktin se aty gjendet shpjegimi mbi çdo të dhënë informative gjeohapësinore të publikuar të vendit, por njëkohësisht si e dhënë parësore e sistemit të Gjeoportali që është dhe baza e ndërtimit të GIS Kombëtar. Në mënyrë të njëpasnjëshme janë renditur çështjet e konstatuara që kërkojnë marrjen e masave nga ana e subjektit:

- Plotësimi mbi të dhënë "Kontakti për burimin" është plotësuar në disa variante: Krijuesi, Autori apo Pronari; Në rastet kur është plotësuar "Krijuesi", nuk është plotësuar institucioni që e administron apo posedon këtë të dhënë të krijuar nga dikush tjetër.
- Në një rast, por nuk përjashtohet mundësia të ketë dhe raste të tjera u konstatua se "Kontakti për burimin" është vendosur ASIG në vend të INSTAT;
- Konformiteti me standardet nuk shënohet tek "Përputhshmëria" pika 7 sipas tabelës 1 në VKM nr.1077, datë 23.12.2015, por shënohet tek "Abstrakti i burimit";
- "Përputhshmëria" pika 7 sipas tabelës 1 në VKM nr.1077, datë 23.12.2015, nuk është përfshirë tek informacioni i shkurtuar, në mënyrë që të publikojë në mënyrë të dukshme për çdo përdorues se sa konform standardit është kjo e dhënë;
- "Kushtet e aksesimit dhe përdorimit" pika 8.1 në tabelën 1, nuk është e paraqitur në metadatë;
- "Përputhshmëria" pika 7 në tabelën 1 është emërtuar në metadatë si "Kualitet" dhe popullohet me një të dhënë standarde që është standardi i INSPIRE;
- Nuk jepet informacion nëse shtresa e aksesuar ka mundësi për download;
- Në disa raste nuk është shënuar telefoni i kontaktit;
- Gjuha e përdorur në metadatë është herë në Shqip e herë në Anglisht dhe jo e përkthyer në mënyrë të përshtatshme;
- Nga ana vizuale "Informacioni" nuk tregon dukshëm dhe në mënyrë të zgjedhur informacion për lexuesin, si institucioni nga e cila kjo e dhënë buron, konformiteti etj. Në rastet e institucioneve që nuk kanë përditësuar informacionin gjeohapësinor, Informacioni të dalë aktiv kur sapo përdoruesi të zgjedhë shtresën, duke i dhënë mundësinë përdoruesit të lexojë së pari metadatën për këtë shtresë e më pas të mund të navigojë.

Kriteri: VKM nr.1077, datë 23.12.2015 "për miratimin e rregullores "për krijimin, ruajtjen dhe përditësimin e metadatave, strukturën e katalogimit dhe afatet e krijimit të metadatave specifike për çdo temë"; Udhëzuesi teknik i detajuar mbi profilin e metadatave.

Ndikimi/efekti: Të dhëna në kundërshtim me aktet ligjore, që shkaktojnë konfuzion në kuptueshmërinë dhe leximin e tyre nga përdoruesit e Gjeoportalit Kombëtar të cilët jo në pak raste janë përdorues të thjeshtë.

Shkaku: Interpretime të ndryshme të VKM nr.1077, datë 23.12.2015 për metadatën (standardi i INSPIRE), mangësi në kontrollin dhe analizimin e të dhënave të plotësuara me qëllim unifikimin e fushave të njëjta.

Rëndësia: E lartë.

6.1 Rekomandimi: ASIG të marrë masa të menjëhershme për sistemimin dhe rregullimin e informacionit gjeohapësinor në të gjitha rastet që janë konstatuar gabime në plotësimin e tyre si numrat e kontaktit apo kontakti i saktë mbi burimin.

6.2 Rekomandimi: ASIG të marrë në konsideratë rregullimin dhe sistemimin e informacionit gjeohapësinor në lidhje me:

- Përkthimin e fushave në gjuhën shqip për ato që rezultojnë vetëm në anglisht;
- Dhënien e informacionit nëse shtresa e aksesuar mund të download-ohet;
- Riorganizimin nga ana vizuale dhe informative të Informacionit të kufizuar që paraqitet për çdo shtresë;
- Plotësimin në "Kushtet e aksesimit dhe përdorimit";
- Plotësimin e të dhënës së përputhshmërisë dhe përfshirjen e saj në informacionin paraprak të çdo shtrese që i paraqitet përdoruesit në vendin e duhur.
- "Kontakti me burimin" të plotësohet me institucionin nga i cili ASIG i ka marrë të dhënat që po publikohen, ndërsa informacioni mbi gjenerimin historik të të dhënave të jetë informacion i dhënë nëpërmjet abstraktit për aq kohë sa është e pamundur nëpërmjet kësaj forme të kemi të renditur të gjitha burimet.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me nr.47/8 Prot. datë 23.06.2021, “Mbi Projektraportin e Auditimit” nga z. LÇ ku janë shprehur objeksione si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: *Për plotësimin e rekomandimit 11.1 është e nevojshme ndërhyrje në sistemin TIK të Gjeoportalit Kombëtar (moduli i databazës dhe administrimit). Këto ndërhyrje janë përfshirë në termat e specifikimeve të mirëmbajtjes së sistemit Gjeoportalit Kombëtar 2021-2023. Siç jemi shprehur në përgjigjen e rekomandimit 8.1, mirëmbajtja e sistemit të Gjeoportalit Kombëtar duhet të zhvillohet nga AKSHI dhe siç mund të konstatohet procedura nuk është realizuar akoma. Për këtë arsye objektive kërkojmë shtyrje të afatit të zbatimit të këtij rekomandimi nga “Menjëherë” në “Në vijimësi”.*

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Për sa më sipër pranohet ky observacion dhe pasqyrimet do të paraqiten në këtë raport përfundimtar të auditimit.

Pretendimi i subjektit: *Mbajmë qëndrimin se Udhëzuesi i sipër përmendur është një akt rregullativ i cili detyron krijimin e metadatave për çdo të dhënë/shërbim gjeohapësinor që do të publikohet në Gjeoportalin Kombëtar, dhe nuk ka nevojë për një akt tjetër rregullativ siç rekomandohet në piken 12.1.*

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Për sa më sipër grupi i auditimit do të rekomandojë të zbatoni ju me përpikmëri dhe të kërkonit për aq sa është në dorën tuaj të respektohen dhe nga subjektet e tjera që i kanë detyrim këto akte ligjore dhe rregullative, kështu do ta rishikojë këtë rekomandim nisur nga ky këndvështrim.

Pretendimi i subjektit: *Për rekomandimin nr.14.1, sqarojmë se ASHK këtë lloj informacioni e jep me pagesë për qytetarët dhe institucionet publike. ASIG nuk disponon dhe nuk ka parashikuar fonde buxhetore për blerjen e këtij informacioni.*

Ndërsa për emërtesat theksojmë se dhe standardi i shkrimit për të dhënat gjeohapësinore për temën “Emërtimet gjeografike”, që përmbajnë të dhënat zyrtare për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, janë konsultuar nga ana e ASIG me Institutin e Gjuhësisë pranë Akademisë së Shkencave.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Për sa më sipër sqarojmë se grupi i auditimit nuk ka sugjeruar të krijoni artifica për marrjen e këtij informacioni, por duke menduar se nga shërbimi i adresarit pronësia sidomos e objekteve shtetërore do të dali gjithsesi, i është referuar dhe ASHK për evidentimin nëse është apo jo shtetërore, duke menduar që institucionet shtetërore nuk e marrin këtë informacion me pagesë, megjithatë ky observacion do të merret në konsideratë.

Lidhur me standardizimin e shkrimit sqarojmë se problemi është më shumë teknik se sa gjuhësor, që do të thotë se duhet unifikuar qyteti psh Tiranë dhe të gjithë duhet ta shkruajnë kështu dhe në asnjë mënyrë tjetër, në të kundërt analizat mbi të dhënat në të ardhmen do të jenë tejet të vështira, për këtë arsye grupi mban të njëjtin qëndrim në këtë rekomandim.

Pretendimi i subjektit: *Për plotësimin e rekomandimit 15.1 është e nevojshme ndërhyrje në sistemin TIK të Gjeoportalit Kombëtar. Këto ndërhyrje janë përfshirë në termat e specifikimeve të mirëmbajtjes së sistemit të Gjeoportalit Kombëtar 2021-2023. Siç jemi shprehur në përgjigjen e rekomandimit 8.1, mirëmbajtja e sistemit të Gjeoportalit Kombëtar duhet të zhvillohet nga AKSHI dhe siç mund të konstatohet procedura nuk është realizuar akoma.*

Për këtë arsye objektive kërkojmë shtyrje të afatit të zbatimit të këtij rekomandimi nga “Menjëherë” në “Në vijimësi”.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Për sa më sipër pranohet ky observacion dhe pasqyrimet do të paraqiten në këtë raport përfundimtar të auditimit.

Pretendimi i subjektit: *Për rekomandimin 16.1, ASIG shprehet që Udhëzuesi e përmbush qëllimin për të cilin është krijuar dhe nuk ka nevojë të ndryshohet, aq më tepër kur ai është në përputhje me VKM-në nr.1077, datë 23.12.2015. Megjithatë në vlerësim të rekomandimit të*

grupit auditues, ju lutemi na specifikoni në detaje se cilat elementë duhen ndryshuar në “Udhëzuesi teknik i detajuar mbi profilin e metadatave”.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Për sa më sipër sqarojmë se plotësimi i metadatës nuk është kryer në përputhje me udhëzuesin për dy arsye: nuk është kuptuar nga subjekti apo nuk është kontrolluar nga ju konformiteti. Ne rekomandojmë rishikimin e tij për efekt qartësimi se çfarë fushe plotëson subjekti dhe sa fusha duhet të plotësojë prsh kur plotësohet me Krijuesin, kur me Autorin dhe kur me Pronarin e kur plotësohen Krijuesi dhe Pronari apo një kombinim tjetër që përmban më shumë se një fushë, pavarësisht sa ju lejon sistemi të plotësoni. Gjithsesi observacioni juaj merret ne konsideratë dhe ky rekomandim do të hiqet në këtë raport.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi biznes planin strategjik të pesëvjeçarit 2015-2020, rezultoi se nuk janë kryer përditësime të ndryshimeve përgjatë kësaj periudhe. Gjithashtu, për vitin 2020 nuk është dokumentuar arritja e objektivave të institucionit bazuar në pikën 3.1.3. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1/a, faqet 12-18 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të ASIG të marrin masat, për rishikimin dhe përditësimin periodik të politikave në strategjinë për vitet 2020-2030 mbi “Qeverisjen e Sektorit të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri”.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se ASIG nuk disponon raporte periodike mbi zbatimin e nenit 6, të rregullores “Gjeoportali Kombëtar”, miratuar me nr.390/7 Prot., datë 19.11.2018 dhe nenit 8 të rregullores “Mbi infrastrukturën TIK të ASIG hostuar pranë DataCenter-it Qeveritar”, miratuar me nr.281 Prot., datë 02.09.2020, që kanë për qëllim matjen e ecurisë së institucionit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1/a, faqet 12-18 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1 Rekomandimi: ASIG të marrë masa, për raportimin dhe dokumentimin e detyrimeve të përcaktuara në rregulloret e Gjeoportalit Kombëtar dhe Infrastrukturën TIK të ASIG, me qëllim zbatimin dhe sigurimin e gjurmës së auditimit mbi mbarëvajtjen dhe matjen e aktivitetit të institucionit.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se ASIG nuk disponon udhëzues apo rregullore, për menaxhimin e përdoruesve që aksesojnë shërbimet dhe funksionalitetet e Gjeoportalit Kombëtar, nëpërmjet portalit E-Albania.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1/a, faqet 12-18 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1 Rekomandimi: Strukturat Drejtuese në ASIG të hartojnë dhe publikojnë, për përdoruesit e web-it nga portali E-Albania një udhëzues, i cili të përmbajë informacionin e plotë mbi mënyrën e regjistrimit, format e regjistrimit, kur krijimi i përdoruesit është i nevojshëm, informimin e saktë dhe qartë mbi mënyrat e aksesimit si dhe të drejtat dhe detyrimet që ka çdo përdorues i krijuar nga ndërfaqja web.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi strukturën e ASIG rezultoi se nga 3 specialistë në Sektorin e Gjeoportalit Kombëtar, në Drejtorinë e GIS-it Kombëtar që përmban struktura, një vend është vakant, çfarë vë në rrezik arritjen e objektivave të këtij sektori.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1/b, faqet 18-20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1 Rekomandimi: ASIG të ndërmarrë masa, për mirë menaxhimin e burimeve njerëzore në plotësimin e vendeve vakante të Sektorit të Gjeoportalit Kombëtar, Drejtoria e GIS-it Kombëtar.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi përshkrimet e punës të specialistëve, miratuar me shkresën nr.344/2 prot, datë 10.08.2018, rezultoi se një nga detyrat funksionale adresohet

gabim tek specialisti në sektorin e Gjeoportalit Kombëtar, pika ë. grupi i auditimit gjykon se, kjo detyrë nuk është adresuar në përputhje me njohuritë teknike dhe profesionale, që specialisti gjeodet disponon, për të ofruar sigurinë dhe mirë funksionimin e sistemeve IT, detyrë e cila i ngarkohet një pozicioni me formim në administrimin e sistemit të gjeoportalit.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1/b, faqet 18-20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1 Rekomandimi: ASIG të ndërmarrë masa për rishikimin e detyrave funksionale të punonjësve në drejtorinë e GIS-it Kombëtar dhe Gjeoportalit, me qëllim adresimin e tyre sa më afër me formimeve profesionale.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi regjistrin e riskut që ka hartuar institucioni, në drejtim të teknologjisë së informacionit, rezulton se, në asnjë formë nuk janë identifikuar dhe dokumentuar risqe lidhur me sistemin ALBCORS.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqet 28-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1. Rekomandimi: ASIG të marrë masa për identifikimin dhe dokumentimin e risqeve për sistemin ALBCORS, si pjesë e regjistrit të institucionit në mënyrë që të jenë identifikuar dhe adresuar rreziqet e mundshme që paraqiten në këtë sistem.

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Gjeoportali Kombëtar është pa mirëmbajtje prej datës 22.11.2018, veprim në kundërshtim me VKM nr.710, datë 21.8.2013 “Për Krijimin dhe Funksionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit” dhe udhëzimin i Ministrisë së Inovacioni dhe Administratës Publike nr.1159, datë 17.3.2014 “Për hartimin e marrëveshjes së nivelit të shërbimit”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet 21-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1 Rekomandimi: AKSHI të marrë masa për mirëmbajtjen dhe administrimin nga ana teknike të Gjeoportalit Kombëtarë.

Menjëherë

7.2 Rekomandimi: AKSHI të identifikojë dhe dokumentojë të gjithë elementët e mirëmbajtjes dhe cilësisë së shërbimeve, të cilat i ofrohen ASIG-ut.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i raporteve mbi marrëveshjen në nivelit të shërbimit nga ASIG me nr.189/1 prot. datë. 06.06.2019, me objekt: “Ofrimi i shërbimeve nga AKSHI për ASIG”, rezultoi se ASIG nuk e mat cilësinë e shërbimeve të AKSHI-t në kundërshtim me pikën 8.ç të udhëzimit nr.1159, datë 17.3.2014 “Për hartimin e marrëveshjes së nivelit të shërbimit”.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet 21-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.1 Rekomandimi: ASIG të marrë masa të menjëhershme për matjen dhe dokumentimin e cilësisë së shërbimeve që rrjedh si detyrim i marrëveshjes në nivel shërbimi me AKSHI-n.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së ndjekur për kryerjen e “back-up” mujor të sistemit të Gjeoportalit Kombëtar nga ASIG me Specialistin e IT të AKSHI-t, rezulton se

procesi nuk dokumentohet dhe nuk kryhen teste periodike për vlefshmërinë e ruajtjes së të dhënave të sistemit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet 21-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

9.1 Rekomandimi: ASIG të kryej analizimin e situatës së gjithë procesit të realizimit të Back - Up dhe të marrë masa të monitorojë dhe dokumentojë të gjithë këtë proces duke shtuar kryerjen e testeve periodike në vijimësi të marrëveshjeve me AKSHI-n.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi të dhënat, dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion për proceset e punës, rezulton se ASIG nuk disponon paraqitje grafike, apo dokumentim të gjurmës së auditimit (logs) në sistemin e Gjeoportalit.

Gjurma elektronike audituese mbi veprimet që ka kryer çdo përdorues mungon, siguria e të dhënave është bazuar në integritetin e punonjësve, sepse sistemi nuk ofron gjurmë digjitale me qëllim adresimin e saktë të prekjes së të dhënave në rast të ndryshimit të tyre. Ky konstatim bazohet në faktin se fushat e të dhënave “*created by*” dhe “*modified by*”, që gjenden në tabelën e roleve, janë “NULL”, çfarë tregon se këto funksionalitete që kanë për qëllim ruajtjen e gjurmës së kryerjes së veprimeve në lidhje me ndryshimet mbi rolet, nuk janë vënë në funksion. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqet 30-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

10.1 Rekomandimi: ASIG të marrë masa, për përmirësimin e bazës së të dhënave në drejtimin e ruajtjes dhe sigurimit të gjurmës digjitale në zbatim të urdhrit ne.109, datë 10.062016, duke e konsideruar në termat e mirëmbajtjes të ofruar nga operatorë të jashtëm apo nga AKSHI, me konsideratën që zgjidhja të suportojë zhvillimet në drejtim të sistemit të GIS-it Kombëtar, për të cilin është menduar të përdoret e njëjta bazë të dhënash bazuar në faktin që është një bazë të dhënash shtetërore.

Në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi:

1. Nga auditimi mbi të dhënat e publikuara në Gjeoportalin Kombëtar rezultuan se disa prej të dhënave nuk janë konform standardit të miratuar, por janë publikuar në Gjeoportali me shënimin “Të dhëna jo konform standardit...”, renditur si më poshtë:

- Rrjetet e Transportit, Infrastruktura rrugore (ARRSH), për: strukturën e emërtimeve dhe numrit të attributeve, katalogut të tipologjisë dhe cilësisë së të dhënave;
- AMBU, Lejet për Hidrocentrale, me institucion gjenerues Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMVV), për: strukturën e emërtimeve dhe numrit të tipologjive, strukturën e emërtimeve dhe numrit të attributeve, katalogut të tipologjisë dhe cilësisë së të dhënave;
- AMBU, Përdorimi i ujit, me institucion gjenerues Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMVV), për: strukturën e emërtimeve dhe numrit të tipologjive, strukturën e emërtimeve dhe numrit të attributeve, katalogut të tipologjisë dhe cilësisë së të dhënave;
- AMBU, Inbotilim, me institucion gjenerues Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMVV), për: strukturën e emërtimeve dhe numrit të tipologjive, strukturën e emërtimeve dhe numrit të attributeve, katalogut të tipologjisë dhe cilësisë së të dhënave;
- AMBU, Pus shpimet, me institucion gjenerues Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMVV), për: strukturën e emërtimeve dhe numrit të tipologjive, strukturën e emërtimeve dhe numrit të attributeve, katalogut të tipologjisë dhe cilësisë së të dhënave;
- Ndërtesat (ASHK), me institucion gjenerues Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për: strukturën e emërtimeve dhe numrit të attributeve, katalogut të tipologjisë dhe cilësisë së të dhënave;

2. Nga auditimi u konstatua se janë publikuar pa informacionin Gjeohapësinor (metadatën):

- Përdorimi i Tokës (Zona e mbulimit);

- Tipet e Tokës (Zona e mbulimit);
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqet 30-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

11.1 Rekomandimi: ASIG si institucion standardizues dhe publikues i të dhënave Gjeohapësinore të marrë masa kontrolluese dhe kundërshtuese për mos publikimin e të dhënave hapësinore në rastet kur metadata nga institucioni dërgues mungon, si e vetmja mënyrë, për të parandaluar publikimin e informacioneve jo të plota gjeohapësinore.

Menjëherë

11.2 Rekomandimi: ASIG si institucion përgjegjës, për respektimin e standardeve gjeohapësinore, të respektojë hartën e proceseve të punës duke i kthyer përgjigje çdo subjekti me të dhëna të detajuara mbi parregullsitë e konstatuara nga kontrollet e konformitetit.

Në vijimësi

11.3 Rekomandimi: ASIG si institucion përgjegjës, për respektimin e standardeve gjeohapësinore, të respektojë hartën e proceseve të punës duke i kthyer përgjigje çdo subjekti me të dhëna të detajuara mbi parregullsitë e konstatuara nga kontrollet e konformitetit.

Brenda 6 muajve

11.4 Rekomandimi: ASIG në bashkëpunim me institucionin përgjegjës të plotësojnë metadata të dhënat gjeohapësinore të shtresave:

- Përdorimi i Tokës (Zona e mbulimit);
- Tipet e Tokës (Zona e mbulimit);

Brenda 3 muajve

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi të dhënat e publikuara në Gjeoportalin kombëtar rezulton se, mungojnë të dhënat gjeohapësinore dhe metadata, për temat dhe autoritetin përgjegjës në tabelën më poshtë:

Nr.	Tema	Autoriteti Përgjegjës
1	Pedologjia	Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB)
2	Shëndeti i njerëzve dhe siguria e tyre	Instituti i Shëndetit Publik (ISHP)
3	Infrastruktura industriale	Ministria e Industrisë dhe Energjetikës (MIE) Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN)
4	Infrastruktura bujqësore dhe akuakultura	Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR)
5	Zonat me përdorim të kufizuar	Agjencia e Zhvillimit të Territorit (AZHT) Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM)
6	Zonat me rreziqe natyrore	Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile
7	Kushtet atmosferike	Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit
8	Meteorologjia	Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit
9	Hidrologjia	Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit
10	Detet	Shërbimin Hidrografik Shqiptar (Komanda e Forcave Detare)
11	Zonat ekologjike	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM)
12	Habitatet	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM)

13	Shpërndarja e specieve	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM) Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM)
----	------------------------	--

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqet 30-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

12.1 Rekomandimi: ASIG në bashkëpunim me autoritet përgjegjëse për temat e mësipërme që zotërojnë informacione gjeohapësinore, e që ende nuk janë publikuar në Gjeoportalin Kombëtar, të cilat janë:

- Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB);
- Instituti i Shëndetit Publik (ISHP);
- Ministria e Industrisë dhe Energjetikës (MIE);
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM);
- Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN);
- Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR);
- Agjencia e Zhvillimit të Territorit (AZHT);
- Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM);
- Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile;
- Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit;
- Shërbimin Hidrografik Shqiptar (Komanda e Forcave Detare);
- Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM);

Të iniciojnë procesin e publikimit të informacionit, pra metadatën përkatëse, si një e drejtë e informimit, për të dhënat të cilat jo vetëm që janë parashikuar në aktet ligjore por nuk do të kenë së shpejti ndonjë sistemi informatik.

Brenda vitit 2021

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi kontrollet e implementuara në sistemin e Gjeoportalit Kombëtar u konstatuan mangësi në drejtim të identifikimit dhe saktësisht, si:

- Nuk jepet informacion nëse ndërtesa ose prona është publike apo private çfarë i shërben informacionit më të detajuar dhe më të plotë të përdoruesve të portalit;
- Mungon standardizimi i shkrimit për të dhëna unike si emrat e qyteteve, emrat e prefekturave, nënprefekturave, emrat e muajve të vitit etj., çfarë krijon pengesa për raportime dhe statistika të ndryshme që vetë institucionit mund ti nevojiten;
- Të dhënat e institucioneve që janë importuar në sistem, nuk i ‘u janë përmbajtur emërtimeve të të dhënave sipas standardit sepse baza e të dhënave për çdo skemë nuk përmban informacionet detyruese të standardit, por rekordi importohet me informacionin dhe emërtimin e fushave që i ka dhënë vetë subjekti dërgues. Prezenca e të dhënave jo të plota dhe mungesa e përcaktimit të të dhënave detyruese për çdo klasë të dhënash, ka krijuar mundësinë e regjistrimit të të dhënave jo të plota, si në rastin e tabelën adr_ndertese: ka të dhëna që ju mungon emri i rrugës, kur është populluar kodi i rrugës apo shape_area;

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqet 30-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

13.1 Rekomandimi: ASIG në bashkëpunim me autoritet përgjegjëse që gjenerojnë informacion për secilën temë, të marrin në konsideratë sistemimet e bazës së të dhënave në lidhje me:

- Shtimin e informacionit nëse ndërtesa ose prona është publike apo private nga adresari apo ASHK, për ato raste kur ky informacion është publik dhe pa pagesë;
- Standardizimi i shkrimit për të dhëna unike si emrat e qyteteve, emrat e prefekturave, nënprefekturave, emrat e muajve të vitit etj.;
- Plotësimin dhe sigurimin e të dhënave që përcaktojnë standardet për çdo klasë, ku më parë të jenë përcaktuar se cilat janë të dhënat detyruese dhe cilat janë të dhënat plotësuese që kërkohen të plotësojnë subjektet për publikimin e informacionit gjeohapësinor.

Brenda 12 muajve

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi të dhënat e përdoruesve rezultoi se:

- Janë krijuar më shumë se 1 përdorues për të njëjtin punonjës, përfshirë dhe punonjësin e firmës që ka ofruar mirëmbajtjen dhe rezultojnë aktivë edhe pse respektivisht testimet e punonjësve të brendshëm kanë përfunduar dhe kontrata e mirëmbajtjes.
- Mungon identifikimi i përdoruesve nëse ai është punonjës publik apo privat, si një ndarje e rëndësishme e cila i shërben analizimit të të dhënave dhe vlerësimit mbi përdorimin e sistemit të Gjeoportalit Kombëtar.
- Nuk janë përcaktuar fushat e detyrueshme në formën e krijimit të përdoruesit nëpërmjet web-it, në mënyrë që vetë përdoruesi të kuptojë rëndësinë e plotësisht të tyre kur kërkon të krijojë një përdorues të sistemit të Gjeoportalit nëpërmjet web-it.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqet 30-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

14.1 Rekomandimi: ASIG të marrë masa për:

- Të hartojë e zbatojë rregulla të mirë përcaktuara mbi të drejtat dhe detyrimet që kanë përdoruesit e brendshëm dhe të jashtëm si përdorues të sistemit.
- Identifikimin e saktë nëse përdoruesit janë të brendshëm, të institucioneve publike apo privat;
- Të identifikojë dhe ti sinjalizojë me simbole të dukshme të dhënat e detyrueshme në formën e krijimit të përdoruesit nga web.

Në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi të dhënat e popullimit të metadatës nga ASIG, u konstatuan disa problematika të cilat tregojnë për parregullsi në plotësimin e një informacioni kaq të rëndësishëm siç është metadata e informacionit gjeohapësinor për faktin se aty gjendet shpjegimi mbi çdo të dhënë informative gjeohapësinore të publikuar të vendit, por njëkohësisht si e dhënë parësore e sistemit të Gjeoportali që është dhe baza e ndërtimit të GIS Kombëtar. Në mënyrë të njëpasnjëshme janë renditur çështjet e konstatuara që kërkojnë marrjen e masave nga ana e subjektit:

- Plotësimi mbi të dhënë "Kontakti për burimin" është plotësuar në disa variante: Krijuesi, Autori apo Pronari; Në rastet kur është plotësuar "Krijuesi", nuk është plotësuar institucioni që e administron apo posedon këtë të dhënë të krijuar nga dikush tjetër.
- Në një rast, por nuk përjashtohet mundësia të ketë dhe raste të tjera u konstatua se "Kontakti për burimin" është vendosur ASIG në vend të INSTAT;
- Konformiteti me standardet nuk shënohet tek "Përputhshmëria" pika 7 sipas tabelës 1 në VKM nr.1077, datë 23.12.2015, por shënohet tek "Abstrakti i burimit";
- "Përputhshmëria" pika 7 sipas tabelës 1 në VKM nr.1077, datë 23.12.2015, nuk është përfshirë tek informacioni i shkurtuar, në mënyrë që të publikojë në mënyrë të dukshme për çdo përdorues se sa konform standardit është kjo e dhënë;
- "Kushtet e aksesimit dhe përdorimit" pika 8.1 në tabelën 1, nuk është e paraqitur në metadatë;
- "Përputhshmëria" pika 7 në tabelën 1 është emërtuar në metadatë si "Kualitet" dhe popullohet me një të dhënë standarde që është standardi i INSPIRE;
- Nuk jepet informacion nëse shtresa e aksesuar ka mundësi për download;
- Në disa raste nuk është shënuar telefoni i kontaktit;
- Gjuha e përdorur në metadatë është herë në Shqip e herë në Anglisht dhe jo e përkthyer në mënyrë të përshtatshme;
- Nga ana vizuale "Informacioni" nuk tregon dukshëm dhe në mënyrë të zgjedhur informacion për lexuesin, si institucioni nga e cila kjo e dhënë buron, konformiteti etj. Në rastet e institucioneve që nuk kanë përditësuar informacionin gjeohapësinor, Informacioni të dalë

aktiv kur sapo përdoruesi të zgjedhë shtresën, duke i dhënë mundësinë përdoruesit të lexojë së pari metadatën për këtë shtresë e më pas të mund të navigojë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqet 30-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

15.1 Rekomandimi: ASIG të marrë masa të menjëhershme për sistemimin dhe rregullimin e informacionit gjeohapësinor në të gjitha rastet që janë konstatuar gabime në plotësimin e tyre si numrat e kontaktit apo kontakti i saktë mbi burimin.

Menjëherë

15.2 Rekomandimi: ASIG të marrë në konsideratë rregullimin dhe sistemimin e informacionit gjeohapësinor në lidhje me:

- Përkthimin e fushave në gjuhën shqip për ato që rezultojnë vetëm në anglisht;
- Dhënien e informacionit nëse shtresa e aksesuar mund të download-ohet;
- Riorganizimin nga ana vizuale dhe informative të Informacionit të kufizuar që paraqitet për çdo shtresë;
- Plotësimin në “*Kushtet e aksesimit dhe përdorimit*”;
- Plotësimin e të dhënës së përputhshmërisë dhe përfshirjen e saj në informacionin paraprak të çdo shtrese që i paraqitet përdoruesit në vendin e duhur.
- “*Kontakttoni me burimin*” të plotësohet me institucionin nga i cili ASIG i ka marrë të dhënat që po publikohen, ndërsa informacioni mbi gjenerimin historik të të dhënave të jetë informacion i dhënë nëpërmjet abstraktit për aq kohë sa është e pamundur nëpërmjet kësaj forme të kemi të renditur të gjitha burimet.

Në vijimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit “Printim Broshura” me fond limit 237.000 lekë pa TVSH rezultoi se, dorëzimi i shërbimit nuk është realizuar në Afatet e përcaktuara në Ftesën për ofertë dhe KPVV duhet të mbante penaltet mbi vonesën për dorëzimin e shërbimit nga OE DK.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2) faqet 21-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandimi: ASIG të marrë të gjitha masat e nevojshme administrative dhe ato ligjore për arkëtimin e vlerës 2.136 Lekë nga OE KD vlerë e cila është përlogaritur si penaltet për mos dorëzim brenda afatit të shërbimit.

Menjëherë

V. ANEKSE

Aneksi 1 "Tabelat e detajuara mbi metadatat jo konform standardit"

Të dhënat	Tema	VKM	Autoriteti Përgjegjës	DATA e inf më të fundit në ASIG
Njësitë Statistikore, Njësitë Qeverisjes Vendore Census (INSTAT)	Njësitë Statistikore	Miratuar me VKM-ne nr.999, datë 09.12.2020	Instituti i Statistikave (INSTAT)	27.10.2014
Njësitë Statistikore, Ndërtesa Census (INSTAT).	Njësitë Statistikore		Instituti i Statistikave (INSTAT)	27.10.2014
Njësitë Statistikore, Grid 1 km ² Census (INSTAT) dendësia e popullsisë për 1 km katror.	Njësitë Statistikore		Instituti i Statistikave (INSTAT)	09.03.2020
Zonat Mbrotjura (Mjedisore)	Zonat Mbrotjura	Miratuar me VKM-ne nr.891, datë 18.11.2020	- Agjencia Kombëtare e Zonave te Mbrotjura (AKZM) Instituti i Monumenteve te Kulturës (IKM)	27.5.2020
Zonimi (Zonat e Mbrotjura)	Zonat Mbrotjura		Agjencia Kombëtare e Zonave te Mbrotjura (AKZM) Instituti i Monumenteve te Kulturës (IKM)	27.5.2020
Monumente Natyre	Zonat Mbrotjura		Agjencia Kombëtare e Zonave te Mbrotjura (AKZM) Instituti i Monumenteve te Kulturës (IKM)	27.5.2020
Monumente Kulture, DRKK	Zonat Mbrotjura		Agjencia Kombëtare e Zonave te Mbrotjura (AKZM) Instituti i Monumenteve te Kulturës (IKM)	27.5.2020

Rrjeti i monitorimit të ujërave të liqeneve	Infrastruktura për Monitorimin e Mjedisit	Në proces miratimi	Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM)	18.06.2019
Rrjeti i monitorimit mikrobiologjik të ujërave bregdetar, larës	Infrastruktura për Monitorimin e Mjedisit		Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM)	18.06.2019
Rrjeti i monitorimit të treguesve në habitatet e dushkajave	Infrastruktura për Monitorimin e Mjedisit		Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM)	18.06.2019
Rrjeti i monitorimit të ajrit	Infrastruktura për Monitorimin e Mjedisit		Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM)	18.06.2019
Rrjeti i monitorimit të ujërave të lumenjve	Infrastruktura për Monitorimin e Mjedisit		Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM)	18.06.2019
Rrjeti i monitorimit të pishës mesdhetare	Infrastruktura për Monitorimin e Mjedisit		Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM)	18.06.2019
Rrjeti i monitorimit të ujërave të ligatinave bregdetare	Infrastruktura për Monitorimin e Mjedisit		Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM)	18.06.2019
Rrjeti i monitorimit të cilësisë së tokës	Infrastruktura për Monitorimin e Mjedisit		Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM)	18.06.2019
Rrjeti i monitorimit të ujërave nëntokësor	Infrastruktura për Monitorimin e Mjedisit		Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM)	18.06.2019
Rrjeti i monitorimit të zhurmave urbane	Infrastruktura për Monitorimin e Mjedisit		Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM)	18.06.2019
Rrjetet e Transportit, Rrugë Rajonale	Rrjetet e Transportit	Miratuar me VKM-ne nr.133, datë 20.03.2019	Instituti i Transportit (IST) Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSH)	24.12.2015
Rrjetet e Transportit, Infrastruktura	Rrjetet e Transportit		Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSH)	19.3.2019

rrugore (ARRSH)				
Harta Gjeologjike 1 : 200 000	Gjeologjia	Miratuar me VKM-ne nr.134, datë 20.03.2019	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH)	17.03.2015
Harta Gjeologjike 1 : 100 000	Gjeologjia		Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH)	27.06.2016
Burimet Minerare, Lejet Minerare të Shfrytëzimit	Burimet Minerare	Miratuar me VKM-ne nr.997, datë 09.12.2020	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore(AKBN) Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH)	17.06.2016
Burimet Minerare, Zonat e planifikuara sipas VKM 347	Burimet Minerare		Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore(AKBN) Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH)	17.06.2016
Burimet Minerare, Zonat e rrezikshme minerare VKM 347	Burimet Minerare		Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore(AKBN) Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH)	17.06.2016
Burimet Minerare, Zonat e rrezikshme minerare VKM 726	Burimet Minerare		Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore(AKBN) Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH)	17.06.2016
Burimet Minerare, Zonat e minierave të vjetra	Burimet Minerare		Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore(AKBN) Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH)	17.06.2016
Burimet Minerare, Lejet Minerare të Shfrytëzimit	Burimet Minerare		Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore(AKBN) Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH)	17.06.2016
Bllloqe Nafte (AKBN)	Burimet Energjetike		Miratuar me VKM-ne nr.950, datë 02.12.2020	M. Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore(AKBN)
Monitorimi i HEC- eve	Burimet Energjetike	M. Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore(AKBN)		08.11.2019

Zonat Urbane (AKPT)	Përdorimi Tokës	i		Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT) Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB) Fushë Krujë	13.08.2015
Plani Përgjithshëm Kombëtar, Infrastruktura e Energjisë	Përdorimi Tokës	i		Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT) Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB) Fushë Krujë	31.10.2017
Plani Përgjithshëm Kombëtar, Sistemi Bujqësor	Përdorimi Tokës	i		Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT) Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB) Fushë Krujë	31.10.2017
Plani Përgjithshëm Kombëtar, Sistemi Natyror	Përdorimi Tokës	i		Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT) Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB) Fushë Krujë	31.10.2017
Plani Përgjithshëm Kombëtar, Sistemi Ujor	Përdorimi Tokës	i		Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT) Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB) Fushë Krujë	31.10.2017
Plani Përgjithshëm Kombëtar, Sistemi Urban	Përdorimi Tokës	i		Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT) Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB) Fushë Krujë	31.10.2017
Plani Përgjithshëm Kombëtar	Përdorimi Tokës	i	Miraturar me VKM-ne nr.811, datë 21.10.2020	Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT) Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB) Fushë Krujë	31.10.2017
PINS Tiranë-Durrës, Ekonomi dhe Turizëm	Përdorimi Tokës	i		Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT) Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB) Fushë Krujë	31.10.2017
PINS Tiranë-Durrës, Sistemi Urban	Përdorimi Tokës	i		Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT)	31.10.2017

			Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB) Fushë Krujë	
PINS Tiranë-Durrës, Sistemi Bujqësor	Përdorimi i Tokës		Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT) Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB) Fushë Krujë	31.10.2017
PINS Tiranë-Durrës, Sistemi Infrastrukturo r	Përdorimi i Tokës		Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT) Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB) Fushë Krujë	31.10.2017
PINS Tiranë-Durrës, Sistemi Natyror dhe Ujor	Përdorimi i Tokës		Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT) Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB) Fushë Krujë	31.10.2017
PINS Bregdeti, Sistemi Urban	Përdorimi i Tokës		Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT) Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB) Fushë Krujë	31.10.2017
PINS Bregdeti, Sistemi Infrastrukturo r	Përdorimi i Tokës		Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT) Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB) Fushë Krujë	31.10.2017
PINS Bregdeti, Sistemi Bujqësor	Përdorimi i Tokës		Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT) Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB) Fushë Krujë	31.10.2017
PINS Bregdeti, Sistemi Natyror	Përdorimi i Tokës	Miraturar me VKM-ne nr.811, datë 21.10.2020	Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT) Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB) Fushë Krujë	31.10.2017
PINS Bregdeti, Sistemi Ujor	Përdorimi i Tokës		Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT) Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB) Fushë Krujë	31.10.2017

PINS Bregdeti, Turizmi	Përdorimi i Tokës		Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT) Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB) Fushë Krujë	31.10.2017
Zonat me Rëndësi Kombëtare, Brezi Bregdetar	Përdorimi i Tokës		Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT) Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB) Fushë Krujë	20.02.2018
Përdorimi i tokës	Përdorimi i Tokës		Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT) Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB) Fushë Krujë	06.06.2019
Përshtatshmëria e tokës	Përdorimi i Tokës		Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT) Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB) Fushë Krujë	06.06.2019
Mbulesa e tokës (Corine 2012)	Mbulesa e Tokës	Miraturar me VKM-ne nr.809, datë 21.10.2020	Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM)	13.03.2019
AMBU, Lejet për Hydrocentrale	Hydrografia	Miraturar me VKM-ne nr.829, datë 07.10.2015	Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMVV)	04.10.2019
AMBU, Përdorimi i ujit	Hydrografia		Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMVV)	04.10.2019
AMBU, Inbotilim	Hydrografia		Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMVV)	04.10.2019
AMBU, Pus shpimet	Hydrografia		Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMVV)	04.10.2019
Institucionet Publike	Infrastruktura Urbane dhe Shërbimet Qeveritare		Agjencia e Zhvillimit të Territorit (AZHT)	25.10.2016
Institucionet Arsimore	Infrastruktura Urbane dhe Shërbimet Qeveritare		Agjencia e Zhvillimit të Territorit (AZHT)	23.12.2014
Posta Shqiptare	Infrastruktura Urbane dhe		Agjencia e Zhvillimit të Territorit (AZHT)	29.08.2017

	Shërbimet Qeveritare			
Stacionet e transmetimit (RTSH)	Infrastruktura Urbane dhe Shërbimet Qeveritare	Miratuar me VKM-ne nr.998, datë 09.12.2020	Agjencia e Zhvillimit te Territorit (AZHT)	28.04.2017
Objektet e Kultit (Komuniteti Mysliman)	Infrastruktura Urbane dhe Shërbimet Qeveritare		Agjencia e Zhvillimit te Territorit (AZHT)	01.07.2020
Objektet e Kultit (Kisha Autoqefale Ortodokse)	Infrastruktura Urbane dhe Shërbimet Qeveritare		Agjencia e Zhvillimit te Territorit (AZHT)	01.07.2020
Objektet e Kultit (Kisha Katolike)	Infrastruktura Urbane dhe Shërbimet Qeveritare		Agjencia e Zhvillimit te Territorit (AZHT)	01.07.2020
Objektet e Kultit (Kryegjyshata Botërore Bektashiane)	Infrastruktura Urbane dhe Shërbimet Qeveritare		Agjencia e Zhvillimit te Territorit (AZHT)	01.07.2020
OST, Linja e transmetimit 110 kV	Infrastruktura Urbane dhe Shërbimet Qeveritare		Agjencia e Zhvillimit te Territorit (AZHT)	11.01.2019
OST, Linja e transmetimit 154 kV	Infrastruktura Urbane dhe Shërbimet Qeveritare		Agjencia e Zhvillimit te Territorit (AZHT)	11.01.2019
OST, Linja e transmetimit 220 kV	Infrastruktura Urbane dhe Shërbimet Qeveritare		Agjencia e Zhvillimit te Territorit (AZHT)	11.01.2019
OST, Linja e transmetimit 400 kV	Infrastruktura Urbane dhe Shërbimet Qeveritare		Agjencia e Zhvillimit te Territorit (AZHT)	11.01.2019
OST, Nënstacione elektrike 110 kV	Infrastruktura Urbane dhe Shërbimet Qeveritare		Agjencia e Zhvillimit te Territorit (AZHT)	11.01.2019
OST, Nënstacione elektrike 220_400 kV	Infrastruktura Urbane dhe Shërbimet Qeveritare	Agjencia e Zhvillimit te Territorit (AZHT)	11.01.2019	

OSHEE, Kabinat elektrike	Infrastruktura Urbane dhe Shërbimet Qeveritare		Agjencia e Zhvillimit te Territorit (AZHT)	19.03.2019
Ndërtesat (ASHK)	Ndërtesat	Miratuar me VKM-ne nr.359, datë 11.05.2016	Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK)	17.07.2020
Ndërtesat (ADRESARI)	Ndërtesat		Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (DPGJC)	20.10.2014
Sistemi i Adresave, Rrugë	Sistemi i Adresave	Miratuar me VKM-ne nr.859, datë 07.12.2016	Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (DPGJC)	20.10.2014
Sistemi i Adresave, Numërtimi	Sistemi i Adresave		Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (DPGJC)	20.10.2014
Zonat Kadastrale	Parcelat Kadastrale	Miratuar me VKM-nr. 321, datë 27.04.2016	Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK)	11.09.2014
Parcelat	Parcelat Kadastrale		Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK)	11.09.2014

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi

Raporti i Përfundimtar i Auditimit dhe Vendimi i Kryetarit të KLSH-së, do të përcillet krahas subjektit të audituar Autoritetit Shtetëror të Informacionit Gjeohapësinor - ASIG dhe Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit - AKSHI.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT